

# VLERËSIMI I INDEKSIT TË INTEGRITETIT PËR KOMISIONERIN PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

RAPORT VLERËSIMI



Institute  
for Democracy  
and Mediation



Suedi  
Sverige



VLERËSIMI I  
INDEKSIT  
TË INTEGRITETIT  
PËR KOMISIONERIN  
PËR TË DREJTËN E  
INFORMIMIT DHE  
MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

RAPORT VLERËSIMI

VLERËSIMI I INDEKSIT TË INTEGRITETIT PËR  
KOMISIONERIN PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT  
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE  
RAPORT VLERËSIMI

**Autorët:**

Prof. Dr. Eralda (Methasani) Çani  
Dktrn. Andrea Mazelliu

**Redaktor letrar:**

Durim Tabaku

**Dizajn dhe layout:**

Eduart Cani

© 2024 nga Instituti për Demokraci dhe  
Ndërmjetësim. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM)

Adresa: Rr. Shenasi Dishnica, Nd.35, H.1

1017 Tirana, Albania

E-mail: [info@idmalbania.org](mailto:info@idmalbania.org)

[www.idmalbania.org](http://www.idmalbania.org)



Institute  
for Democracy  
and Mediation



Suedi  
Sverige

*Ky dokument u hartua në kuadër të Projektit "Forcimi i integritetit për përmirësimin e shërbimeve publike" zbatuar nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) me mbështetjen financiare të Ambasadës së Suedisë në Tiranë. Pikëpamjet dhe mendimet e shprehura në këtë dokument nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet dhe qëndrimet e Ambasadës së Suedisë.*

# TABELA E PËRMBAJTJES

<b>HYRJE</b>	<b>5</b>
<b>METODOLOGJIA E VLERËSIMIT TË INTEGRITETIT TË INSTITUCIONEVE PUBLIKE</b>	<b>6</b>
<b>1. INDEKSI I INTEGRITETIT - LLOGARIDHËNIA</b>	<b>9</b>
1.1 KUADRI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL	20
1.2 KONTROLLI I ZBATIMIT NË PRAKTIKË	20
1.3 REKOMANDIME PËR LLOGARIDHËNIEN	22
<b>2. INDEKSI I INTEGRITETIT – TRANSPARENCA PROAKTIVE</b>	<b>23</b>
2.1 KUADRI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL	32
2.2 KONTROLLI I ZBATIMIT NË PRAKTIKË	32
2.3 REKOMANDIME PËR TRANSPARENCËN PROAKTIVE	33
<b>3. INDEKSI I INTEGRITETIT - QASJA STRATEGJIKE</b>	<b>34</b>
3.1 KUADRI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL	41
3.2 KONTROLLI I ZBATIMIT NË PRAKTIKË	41
3.3 REKOMANDIME PËR QASJEN STRATEGJIKE	43
<b>4. INDEKSI I INTEGRITETIT - STANDARDET ETIKE DHE TË SJELLJES SË MIRË</b>	<b>44</b>
4.1 KUADRI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL	49
4.2 KONTROLLI I ZBATIMIT NË PRAKTIKË	49
4.3 REKOMANDIME PËR STANDARDET ETIKE DHE TË SJELLJES SË MIRË	49
<b>5. INDEKSI I INTEGRITETIT – MERITOKRACIA</b>	<b>50</b>
5.1 KUADRI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL	58
5.2 KONTROLLI I ZBATIMIT NË PRAKTIKË	59
5.3 REKOMANDIME PËR MERITOKRACINË:	60
<b>6. VLERËSIMI I PËRGJITHSHËM SIPAS INDEKSEVE</b>	<b>61</b>

## SHKURTIME

ASPA	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike
EMP	Ekipi i Menaxhimit të Programit
GMS	Grupi i Menaxhimit Strategjik
IDM	Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim
ILDKPKI	Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave
KDIMDHP	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
KMSHC	Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil
MBZHR	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
MD	Ministria e Drejtësisë
PBA	Plani Buxhetor Afatmesëm
PSV	Procedurë Standarde e Veprimit
PT	Programi i Transparencës
RENJK	Regjistri Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

# HYRJE

Raporti i monitorimit “Vlerësimi i Indeksit të Integritetit të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale” synon të pasqyrojë ndikimin e masave të ndërmarra nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDIMDHP) në forcimin e integritetit institucional. Referuar këtij raporti, KDIMDHP vlerësohet në tërësi si një institucion me një nivel të lartë të përgjegjshmërisë institucionale për sa i përket transparencës proaktive, llogaridhënies, qasjes strategjike ndaj standardeve të integritetit dhe sjelljes së mirë, si dhe meritokracisë në përmbushjen e detyrave, në përputhje me ligjin dhe aktet nënligjore në fuqi.

Indeksi i integritetit është një mekanizëm me anë të të cilit vlerësohen kuadri institucional për promovimin e integritetit dhe luftën kundër korrupsionit, kapacitetet e KDIMDHP-së për përmbushjen e objektivave të integritetit të vendosura nëpërmjet planeve të integritetit, transparenca dhe llogaridhënia ndaj përfituesve të shërbimeve, si dhe nëse KDIMDHP e realizon veprimtarinë e saj në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Ky indeks është një instrument që shërben si material burimor për realizimin e veprimtarisë funksionale të KDIMDHP-së dhe për të përmbushur objektivat institucionale dhe ato të integritetit. Ai përdoret për të përmirësuar cilësinë e punës dhe shërbimeve publike që ofron institucioni dhe kontribuon në forcimin e një kulture pro-integritet dhe të transparencës institucionale.

Raporti i monitorimit të indeksit të integritetit institucional të KDIMDHP-së u hartua duke vlerësuar zbatimin e Planit të Integritetit 2022-2025, masat e marra për forcimin e integritetit institucional, nivelin e zbatimit të Programit të Transparencës, si dhe ndërveprimin e tij me aktorë të tjerë, përfshirë edhe publikun në tërësi.

Referuar fushave të vlerësimit të integritetit të KDIMDHP-së, përkatësisht llogaridhënies, transparencës proaktive, qasjes strategjike ndaj integritetit, standardeve etike dhe sjelljes së mirë, si dhe meritokracisë së burimeve njerëzore, në tërësi, vlerësohet se institucioni ka marrë masa serioze për të forcuar rolin e tij në luftën kundër korrupsionit dhe në promovimin e qeverisjes së mirë. Sipas metodologjisë së projektit, në fushën ‘llogaridhënia’ si dhe ‘standartet etike dhe të sjelljes së mirë’, institucioni është vlerësuar me maksimumin e pikëve, në fushën ‘transparenca proaktive’ është vlerësuar me 19 pikë nga 20 pikë, në fushën ‘qasja strategjike ndaj integritetit’ me 18 pikë nga 20 pikë, si dhe ‘meritokracia e burimeve njerëzore’ me 17 nga 20 pikë.

Ky raport, që ofron një vlerësim të gjendjes aktuale të institucionit, shërben edhe si mjet i frytshëm për përmirësime të mëtejshme të integritetit institucional dhe mund të shndërrohet në një mekanizëm vlerësimi të vazhdueshëm.

Raporti i monitorimit të indeksit të integritetit u hartua me mbështetjen e Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM). Procesi i hartimit të këtij raporti kontribuoi në forcimin e mëtejshëm të ndërveprimit mes KDIMDHP-së dhe shoqërisë civile në vend.

# METODOLOGJIA E VLERËSIMIT TË INTEGRITETIT TË INSTITUCIONEVE PUBLIKE

Raporti i Monitorimit të Indeksit të Integritetit të KDIMDHP-së është përpiluar bazuar në "Indeksin e integritetit të institucioneve publike"<sup>1</sup>, metodologjia e vlerësimit të integritetit të institucioneve publike e hartuar nga IDM.

Për këtë vlerësim janë përdorur metoda cilësore dhe sasiore. Duke u bazuar në hulumtimet e kryera të informacionit të marrë në faqen zyrtare të KDIMDHP-së, në të dhënat e marra nga strukturat përgjegjëse dhe kryqëzimin e informacionit, janë matur treguesit e metodologjisë së vlerësimit të integritetit, me shpjegime për secilin prej tyre.

Vlerësimi është bazuar në analizën cilësore të faqes së internetit të KDIMDHP-së, takimet me përfaqësuesit e tij dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion pas këtyre takimeve. Në institucion janë mbajtur tre takime për të përcaktuar shtyllat themelore të vlerësimit si dhe aktet apo veprimet që nevojiteshin të vlerësoheshin në kuadër të analizës, përkatësisht në datat 10 maj 2024, 5 korrik 2024 dhe 19 shtator 2024.

Vlerësimi i kuadrit ligjor dhe institucional është kryer duke analizuar përmbajtjen e kriterëve të përcaktuara në metodologji, ndërsa kontrolli i zbatimit në praktikë është realizuar duke marrë parasysh dokumentet, aktet, komunikimet e kryera gjatë veprimtarisë së institucionit apo edhe raportet nga institucione të ndryshme me qëllim vlerësimin e nivelit të zbatimit në praktikë të kriterëve ligjore.

Sipas metodologjisë, janë përcaktuar 5 fusha vlerësimi, të cilat bazohen në dy kriterë kryesorë: kontrolli ligjor dhe institucional, dhe kontrolli i zbatimit në praktikë. Pesë fushat e vlerësimit janë: 1. llogaridhënia, 2. transparencë proaktive, 3. qasja strategjike, 4. standardet etike dhe të sjelljes së mirë, dhe 5. meritokracia. Çdo fushë vlerësohet maksimalisht me 20 pikë, të ndara në mënyrë të barabartë mes dy kriterëve, nga 10 pikë secila. Bazuar në këto të dhëna, KDIMDHP është vlerësuar me pikë për secilën fushë si më poshtë.

<b>1.Llogaridhënia</b>	<b>20 pikë</b>	<i>nga 20</i>
kontrolli ligjor	<b>10 pikë</b>	<i>nga 10</i>
kriteri i zbatimit në praktikë	<b>10 pikë</b>	<i>nga 10</i>
<b>2. Transparenca proaktive</b>	<b>18 pikë</b>	<i>nga 20</i>
kontrolli ligjor	<b>8 pikë</b>	<i>nga 10</i>
kriteri i zbatimit në praktikë	<b>10 pikë</b>	<i>nga 10</i>

1 Divjak, B., Agolli, M. 2024. Indeksi i integritetit të institucioneve publike, Tiranë: Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, <https://idmalbania.org/sq/indeksi-i-integritetit-te-institucioneve-publike-janar-2024/>




<b>3. Qasja strategjike ndaj integritetit</b>	<b>17 pikë</b>	<i>nga 20</i>
kontrolli ligjor	9 pikë	<i>nga 10</i>
kriteri i zbatimit në praktikë	8 pikë	<i>nga 10</i>

<b>4. Standardet etike dhe të sjelljes së mirë</b>	<b>16 pikë</b>	<i>nga 20</i>
kontrolli ligjor	10 pikë	<i>nga 10</i>
kriteri i zbatimit në praktikë	6 pikë	<i>nga 10</i>

<b>5. Meritokracia e burimeve njerëzore</b>	<b>15 pikë</b>	<i>nga 20</i>
kontrolli ligjor	8 pikë	<i>nga 10</i>
kriteri i zbatimit në praktikë	7 pikë	<i>nga 10</i>

Grafiku 1 pasqyron gjetjet në tërësi për Indeksin e integritetit të KDIMDHP-së, duke iu referuar secilës prej fushave dhe kriterëve.




Kështu, institucioni vlerësohet me 86 pikë nga 100 pikë të mundshme, duke nënkuptuar se ai është i fortë dhe i pavarur, me një nivel të lartë integriteti në organizimin dhe veprimtarinë e tij.

Në bazë të pikëzimit për çdo fushë, lidhur me kontrollin ligjor dhe institucional, KDIMDHP vlerësohet me 45 pikë, duke treguar kështu një nivel të lartë të zhvillimit të integritetit institucional. Pavarësisht se KDIMDHP është një institucion relativisht i vogël, ai vlerësohet si një nga institucionet me një proaktivitet të lartë në rritjen e standardeve të integritetit mbi të cilat bazohet veprimtaria e tij. Aktet rregullatore të KDIMDHP-së janë publike. Nga takimet e zhvilluara në institucion rezultojnë se çdo punonjës është i njohur me to dhe i mirë-informuar për zbatimin e tyre.

Lidhur me kriterin e dytë, atë të kontrollit të zbatimit në praktikë, KDIMDHP është vlerësuar me 41 pikë, duke treguar një nivel të lartë të zbatimit të kriterëve të integritetit institucional dhe se aktet dhe rregulloret kanë një shkallë të lartë dhe efikasitet zbatueshmërie. Kjo vërehet edhe në auditimet e përputhshmërisë dhe ligjshmërisë si dhe në rezolutat e Kuvendit për këtë institucion. Shih grafikun 2.

Grafiku 2. Realizimi i kriterëve të vlerësimit të Indeksit të Integritetit të KDIMDHP-së



# 1. INDEKSI I INTEGRITETIT - LLOGARIDHËNIA

Kontrolli ligjor dhe institucional	Verifikimi	Vlerësimi	Shënime dhe analiza
<b>Transparenca proaktive</b>	Publikimi në faqen zyrtare të internetit i kontakteve për Koordinatorin për të Drejtën e Informimit	2 pikë nga 2	Një ndër aspektet përmes me anë të së cilës vlerësohet transparenca proaktive e institucionit është edhe publikimi i qartë dhe i plotë i kontaktit të koordinatorit të institucionit për të drejtën e informimit në faqen e internetit sipas kërkesës së Ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar dhe Urdhrit të KDIMDHP Nr. 32, datë 24.3.2021, “Për miratimin e Programit të Transparencës” të rishikuar. <sup>2</sup> KDIMDHP ka miratuar me Urdhër Nr. 09, datë 12.01.2015, “Për caktimin e koordinatorit për të drejtën e informimit” (shkresa Nr. 39 prot., datë 12.01.2015) – Komisioneri për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale. <sup>3</sup> znj. Alketa Koja si Koordinatore për të Drejtën e Informimit. Ky informacion gjendet i publikuar në faqen e internetit të institucionit, Programi i Transparencës, së bashku me numrin e telefonit, adresën e kontaktit si dhe orarin e pritjes në institucion. <sup>4</sup>

2 Urdhri Nr. 32, datë 24.3.2021, “Për Miratimin e Programit të Transparencës të Rishikuar të Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale” (i ndryshuar), Aksesuar nga: [https://idp.al/wp-content/uploads/2024/02/Urdhri\\_i-miratimit\\_te\\_PT\\_2021.pdf](https://idp.al/wp-content/uploads/2024/02/Urdhri_i-miratimit_te_PT_2021.pdf) (aksesuar në 1 korrik 2024).

3 Urdhri Nr. 09, datë 12.01.2015, “Për caktimin e koordinatorit për të drejtën e informimit” (shkresa Nr. 39 prot., datë 12.01.2015) – Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, është marrë kopje fizike në institucion gjatë takimit të datës 10 maj 2024.

4 <https://idp.al/koordinator-transparenca> (aksesuar në 30 qershor 2024).

Kontrolli ligjor dhe institucional	Verifikimi	Vlerësimi	Shënime dhe analiza
	Publikimi i rregullores së brendshme të institucionit të miratuar.	2 pikë nga 2	Institucioni ka në fuqi Rregulloren e Brendshme të miratuar me Urdhrin Nr. 46/2024 të KDIMDHP-së. <sup>5</sup> Kjo rregullore është publikuar në faqen e internetit të institucionit dhe është përditësuar në vitin 2024, si pasojë e ndryshimeve të bëra nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në strukturën, organikën dhe klasifikimin e pagave të KDIMDHP. <sup>6</sup> Rregullorja përmban, përveç rregullave të hollësishme për organizimin dhe funksionimin e zyrës së Komisionerit edhe organikën e institucionit, <sup>7</sup> modelin e akteve administrative të Komisionerit, modelin e dokumenteve që dalin nga institucioni, modelin e dokumenteve që dalin nga institucioni në mungesë dhe me urdhër, modelin e dokumenteve të brendshme, modelin e marrëveshjeve ndërinstitucionale, dhe modelin e shkresës së kthim përgjigjes nga Koordinatorin për të Drejtën e Informimit. <sup>8</sup>

5 Rregullorja e Brendshme e Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale e miratuar me Urdhrin Nr. 46, datë 16.02.2024, “Për miratimin e rregullores së brendshme të zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale” sipas Vendimit të Kuvendit të Republikës të Shqipërisë, Nr. 86/2018, “Për miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimin e pagave të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar me Vendimin Nr. 24/2023 dhe Nr. 8/2024.

6 <https://www.idp.al/rregullore/> (aksesuar në 30 qershor 2024).

7 Po aty, Aneksi 1.

8 Po aty, fq. 24-29, aksesuar nga: <https://idp.al/rregullore/> (aksesuar në 20 korrik 2024)

Kontrolli ligjor dhe institucional	Verifikimi	Vlerësimi	Shënime dhe analiza
<b>Kuadri konsultativ</b>	Publikimi i planit vjetor të konsultimit publik.	2 pikë nga 2	Ligji Nr. 146/2014, “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, rregullon procesin e njoftimit dhe konsultimit publik të projekt-ligjeve, projekt-dokumente strategjike kombëtare dhe vendore, si dhe politikave me interes të lartë publik. <sup>9</sup> Referuar kompetencave të KDIMDHP-së, si dhe fushës së zbatimit të ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik, ky institucion nuk përfshihet në tërësinë e institucioneve që ngarkohen me detyrimin e realizimit të proceseve të konsultimit publik. Institucioni nuk është një institucion hartues i projektligjeve, dokumenteve strategjike kombëtare dhe vendore, apo politikave me interes të lartë publik, si rezultat nuk ka një rol udhëheqës në proceset e konsultimit publik. KDIMDHP nuk ka një plan vjetor për konsultimin publik. Pavarësisht këtij statusi ligjor, institucioni është treguar mjaft aktiv në proceset e konsultimit publik në rastet kur janë ndërmarrë procese projekt-ligjesh të lidhura ngushtë me kompetencat themelore të këtij institucioni, si e drejta për informim apo të dhënat personale. I tillë është rasti i bashkëpunimit me Ministrinë e Drejtësisë (MD) përgjatë procesit të konsultimit të Projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 119/2014 ‘Për të drejtën e informimit’” gjatë vitit 2022, <sup>10</sup> proces në të cilin kontributi ka qenë i qenësishëm. KDIMDHP ka ndarë bashkërisht me MD-në peshën e mbarëvajtjes së të gjithë këtij procesit të konsultimit të këtij projektligji. Po ashtu, KDIMDHP ka dhënë kontribut të rëndësishëm, në bashkëpunim me MD-në, në procesin e konsultimit publik të Projektligjit të ri “Për mbrojtjen e të dhënave personale”. <sup>11</sup> Këta shembuj, edhe pse të pa kërkuar nga kuadri ligjor në fuqi për konsultimin publik, janë tregues mjaft pozitiv i angazhimit të ndërgjegjshëm institucional për zhvillimin e kuadrit ligjor në fushën e të drejtës për informim dhe të dhënave personale duke marrë në konsideratë tërësinë e kompetencave të KDIMDHP-së.

9 Neni 1 parag. 1 i Ligjit Nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”

10 <https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/528> (aksesuar në 20 korrik 2024)

11 <https://idp.al/2021/12/16/konsultimi-publik-per-projektligjin-e-ri-per-mbrojtjen-e-te-dhenave-personale-dhe-permiresimet-e-ligjit-per-te-drejte-e-informimit/> (aksesuar në 20 korrik 2024)

Kontrolli ligjor dhe institucional	Verifikimi	Vlerësimi	Shënime dhe analiza
	Institucioni ka të arkivuara procesverbalet e takimeve konsultative, inputin e marrë nga platformat online të konsultimit publik.	2 pikë nga 2	<p>KDIMDHP, pavarësisht se ligji nuk kërkon prej këtij institucioni një rol aktiv në procesin e konsultimit publik, ka luajtur një rol proaktiv në këtë proces në kuadër të hartimit të projektligjeve të ndryshme që lidhen me fushën e veprimtarisë së institucionit. Një prej tyre është ka të bëjë me hartimin e ndryshimeve ligjore në ligjin për të drejtën e informimit, proces për të cilin Ministria e Drejtësisë ka pasur rolin e institucionit udhëheqës.<sup>12</sup> KDIMDHP ka luajtur rolin e institucionit mbështetës në procesin e konsultimit të Projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin ‘Për të drejtën e informimit’”, të cilin e ka publikuar në faqen e saj të internetit ku ftonte të gjithë grupet e interesit – shoqëri civile, gazetarë/media, apo qytetarë – të jepnin kontributin e tyre në përmirësimin e mëtejshëm të projektligjit, duke dërguar propozimet pranë Ministrisë së Drejtësisë deri më 15.11.2022.<sup>13</sup> Për më tepër, dy nga tre personat e kontaktit të Raportit të Vlerësimit të Ndikimit të hartimit të këtij projektligji ishin punonjës të KDIMDHP-së.<sup>14</sup> Gjithashtu, institucioni ka dhënë kontribut edhe gjatë procesit të konsultimit në hartimin e Projektligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.<sup>15</sup></p> <p>Mund të përmendim se ky autoritet është mbikëqyrës për shqyrtimin e ankesave që burojnë nga Ligji Nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”.<sup>16</sup> Madje, institucioni ka caktuar një koordinator për konsultimin publik, që është, znj. Alketa Koja.<sup>17</sup> Gjatë takimeve në institucion, koordinatori na konfirmoi se për vitin 2023 nuk janë administruar ankesa nga palë të interesuara, por ka pasur praktika administrative dhe komunikim shkresor me institucione apo grupe interesi në lidhje me këtë proces.</p>

12 <https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/528> (aksesuar në 20 korrik 2024)

13 <https://idp.al/2022/10/25/procesi-i-konsultimit-publik-per-permiresimin-e-ligjit-per-te-drejte-e-informimit/>

14 [https://konsultimipublik.gov.al/documents/RENJK\\_528\\_13.10.2022-RIA-LDI---ripunuar.docx](https://konsultimipublik.gov.al/documents/RENJK_528_13.10.2022-RIA-LDI---ripunuar.docx)

15 <https://idp.al/2022/07/12/konsultimi-publik-i-projektligjit-per-mbrojtjen-e-te-dhenave-personale/>

16 Neni 21 i ligjit Nr. 146/2014, “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”

17 <https://idp.al/koordinator-per-njoftimin-dhe-konsultimin-publik/>

Kontrolli ligjor dhe institucional	Verifikimi	Vlerësimi	Shënime dhe analiza
	Publikimi i raportit vjetor për konsultimin publik.	2 pikë nga 2	Ky kriter është i pazbatueshëm në rastin e KDIMDHP-së, pasi institucioni nuk është udhëheqës për projektligj në procesin e konsultimit publik (shih më sipër) dhe, si rrjedhojë, nuk është i ngarkuar për të përpiluar raportin vjetor të konsultimit publik. Gjithsesi, në raportin vjetor që i paraqet Kuvendit të Shqipërisë, KDIMDHP ka bërë transparencën e nevojshme të angazhimit të tij në proceset e konsultimit publik kur kjo ka ndodhur, <sup>18</sup> sikurse në çdo rast paraqet informacion mbi rolin e tij si shqyrtues i ankesave për proceset e konsultimeve publike në përputhje me kompetencën që i është ngarkuar me Ligjin Nr. 146/2014, "Për njoftimin dhe konsultimin publik". <sup>19</sup>
<b>Kontrolli ligjor dhe institucional</b>		<b>10 pikë nga 10</b>	

18 Konkretisht për rolin e tij në procesin e konsultimit publik të hartimit të projektligjit për të dhënat personale shih: <https://idp.al/wp-content/uploads/2024/01/Raporti-Vjetor-2022.pdf>, në fq. 28.

19 Shih raportet vjetore të KDIMDHP-së, në <https://idp.al/raporte-vjetore/>

Kontrolli i zbatimit në praktikë	Verifikimi	Vlerësimi	Shënime dhe analiza
<b>Transparenca e institucionit</b>	Programi i Transparencës së institucionit është i plotësuar dhe i përditësuar.	2 pikë nga 2	Programi i Transparencës (PT) i publikuar në faqen e internetit të KDIMDHP përmban të gjitha elementet sipas përcaktimeve të ligjit për të drejtën e informimit dhe Urdhrit të Komisionerit Nr. 32, datë 24.03.2021, "Për miratimin e Programit të Transparencës të rishikuar të zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale". <sup>20</sup> PT-ja e miratuar me Urdhrin Nr. 32, datë 24.3.2021, përmban 13 elemente, të cilat të gjitha përmbajnë informacione dhe adresa aktive. <sup>21</sup> Gjatë takimit të fundit me Koordinatorin për të Drejtën e Informimit dhe përfaqësues të tjerë të institucionit, në datën 19 shtator 2024, na u bë me dije se faqja e institucionit aktualisht ndodhet në proces rindërtimi me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të saj dhe akses më të lehtë të qytetarëve dhe grupeve të tjera të interesit. <sup>22</sup>

20 [https://idp.al/wp-content/uploads/2024/02/Urdhri\\_i-miratimit\\_te\\_PT\\_2021.pdf](https://idp.al/wp-content/uploads/2024/02/Urdhri_i-miratimit_te_PT_2021.pdf)

21 [https://idp.al/programi\\_i\\_transparences/](https://idp.al/programi_i_transparences/)

22 Takimi u zhvillua në datën 5 korrik 2024 në zyrën e KDIMDHP-së.



Kontrolli i zbatimit në praktikë	Verifikimi	Vlerësimi	Shënime dhe analiza
Raporti i kërkesave për informim që kanë marrë përgjigje kundrejt totalit të kërkesave për informim që i janë drejtuar institucionit.	1 pikë nga 1	<p>Nga analiza e ‘Regjistrimit të Kërkesave dhe Përgjigjeve’ sipas modelit të miratuar nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, me Urdhrin Nr. 188, datë 18 dhjetor 2020, “Për miratimin e regjistrimit të kërkesave dhe përgjigjeve të rishikuar”,<sup>23</sup> rezulton se ky regjistër është i hedhur dhe përditësuar në faqen e internetit të institucionit që nga viti 2015.<sup>24</sup> Raporti i kërkesave të dërguara dhe përgjigjeve për vitin 2024 është 15 kërkesa në total, prej të cilave 14 janë plotësuar dhe kthyer përgjigje, ndërsa 1 kërkesë rezulton në proces me objekt ‘Dërguar fatura për arkëtim për kopje CD’ (kërkesa me nr. rendor 2).<sup>25</sup> Për vitin 2023, rezulton se janë kthyer përgjigje për 24 kërkesa, dhe një praktikë ende në proces, të cilën institucioni e reflekton si: ‘Në pritje të pagesës së faturës për arkëtim nga ana e kërkuarit’ (kërkesa me nr. rendor 24).<sup>26</sup></p> <p>Për vitin 2022 të gjitha kërkesat janë të plotësuara.<sup>27</sup> Nga vlerësimi i periudhës trevjeçare rezulton se nga 58 kërkesa të bëra gjatë këtyre 3 (tre) viteve, vetëm dy kërkesa pasqyrohen si në proces me objekt ‘Në pritje të pagesës për arkëtim’, por për të dyja është kthyer përgjigje brenda afatit.</p>	

23 [https://idp.al/wp-content/uploads/2024/02/Urdher\\_Nr.188.pdf](https://idp.al/wp-content/uploads/2024/02/Urdher_Nr.188.pdf)

24 <https://idp.al/regjistri-i-kerkesave-dhe-pergjigjeve/>

25 <https://idp.al/regjistri-i-kerkesave-dhe-pergjigjeve-2024/>

26 <https://idp.al/regjistri-i-kerkesave-dhe-pergjigjeve-2023/>

27 <https://idp.al/regjistri-i-kerkesave-dhe-pergjigjeve-2022/>

Kontrolli i zbatimit në praktikë	Verifikimi	Vlerësimi	Shënime dhe analiza
	Numri mesatar i ditëve për kthimin e përgjigjes ndaj kërkesave për informacion.	1 pikë nga 1	<p>Mesatarja e ditëve të kthimit të përgjigjeve për vitin 2024 (deri në datën 15.9.2024) është 8.5 ditë me gjithsej 15 kërkesa.<sup>28</sup> Për vitin 2023 janë publikuar 25 kërkesa me një mesatare të kthimit të përgjigjes prej 8.6 ditësh, ndërsa për vitin 2022 ka pasur 18 kërkesa me një mesatare prej 5 ditësh.<sup>29</sup></p> <p>Bazuar në kriteret e Indeksit të Integritetit të Institucioneve Publike, institucioni vlerësohet me pikët maksimale, me një mesatare prej 7.36 ditësh për të tre vitet, për kthimin e përgjigjeve nga marrja e kërkesës. Shih grafikun 3.</p>
	Institucioni vë në dispozicion të publikut një faqe dinamike interneti ku ofrohet informacion i përditësuar dhe publiku informohet në kohë.	2 pikë nga 2	<p>Faqja e internetit e institucionit vlerësohet se është ndërvepruese dhe rubrika e njoftimeve është e përditësuar me njoftime të shpeshta dhe të vazhdueshme. Ato rezultojnë të përditësuara edhe me njoftime për çdo muaj pothuaj në rubrikat 'Njoftime për Shtyp' dhe 'Aktivitete të Zyrës së Komisionerit'.<sup>30</sup> Gjatë muajit shtator 2024 numri i njoftimeve është 9 dhe i aktiviteteve 4, për muajin korrik numri i njoftimeve është 5, për muajin qershor 12, etj.<sup>31</sup> Rezulton që ka pasur gjithsej 89 njoftime dhe aktivitete të pasqyruara në faqen e institucionit, me një mesatare prej 7.4 njoftime/aktivitete për çdo muaj gjatë vitit 2023, dhe 67 nga janari deri në shtator 2024, me të njëjtën mesatare prej 7.4 në muaj edhe gjatë këtij viti. Shih grafikët 4 dhe 5.</p> <p>Po ashtu, publiku është informuar për raportet e monitorimit të veprimtarisë financiare të institucionit. KDIMDHP e ka publikuar raportin dhe relacionin e monitorimit financiar mbi performancën e produkteve/ shpenzimeve për periudhën janar – prill 2024,<sup>32</sup> si edhe raportin dhe relacionin e monitorimit financiar të tre viteve të kaluara, 2021-2022-2023.<sup>33</sup></p>

28 <https://idp.al/regjistri-i-kerkesave-dhe-pergjigjeve-2024/>

29 <https://idp.al/regjistri-i-kerkesave-dhe-pergjigjeve-2023/>; <https://idp.al/regjistri-i-kerkesave-dhe-pergjigjeve-2022/>

30 <https://idp.al/njoftimet-per-shtyp/>

31 Po aty.

32 <https://idp.al/wp-content/uploads/2024/06/RELACION-MBI-MONITORIMIN-janar-Prill-2024.pdf>

33 <https://idp.al/buxheti-i-zyres-se-komisionerit/> (aksesuar në datën 10 shtator 2024)

Kontrolli i zbatimit në praktikë	Verifikimi	Vlerësimi	Shënime dhe analiza
<b>Institucionalizimi i konsultimeve publike</b>	Raporti mes planit vjetor të konsultimit publik/realizimit të konsultimit publik.	2 pikë nga 2	<p>Sikurse u sqarua më lart, ky kriter është i pazbatueshëm në rastin e KDIMDHP-së, pasi institucioni nuk është udhëheqës për projektligjet në procesin e konsultimit publik (shih më lart) dhe, si rrjedhojë, nuk është i ngarkuar për të përpiluar raportin vjetor të konsultimit publik.</p> <p>Në raportin e vitit 2023, KDIMDHP raporton se, përveç kompetencës për mbikëqyrjen e shqyrtimit të ankesave që burojnë nga Ligji Nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, gjatë këtij viti nuk janë administruar ankesa nga palët e interesuara. Institucioni ka luajtur një rol aktiv në bashkërendimin e procesit të konsultimit publik për projekt-ligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 119/2014 ‘Për të Drejtën e Informimit’”. Gjatë vitit 2023, KDIMDHP, në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë, finalizuan procesin e konsultimit publik të ndryshimeve të ligjit për të drejtën e informimit, duke zhvilluar një takim përmblyës me përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile, medias, etj. Ky ligj u miratua nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në seancën plenare të datës 21.09.2023, duke përfunduar një proces konsultimi me qytetarët, shoqërinë civile, grupet e interesit dhe autoritetet publike.</p> <p>Gjithashtu, Zyra e Komisionerit ka marrë pjesë në aktivitetin e Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim për diskutimin e ndryshimeve në ligjin për njoftimin dhe konsultimin publik. Gjatë vitit 2023, KDIMDHP bashkëpunoi me organizatat dhe mediat investigative për të nxitur ndërgjegjësimin dhe promovimin e të drejtës për informim, si dhe rëndësinë e procesit të konsultimit publik në kuadër të kontrollit dhe pjesëmarrjes në qeverisje.<sup>34</sup> Duke qenë se ky institucion nuk është një institucion udhëheqës në proceset e konsultimit publik, roli i tij proaktiv në këto procese përqendrohet në mbikëqyrjen e tyre ndaj ankesave të ndryshme, kompetencë të cilën institucioni e reflekton në raportimin vjetor për Kuvendin.<sup>35</sup></p>

34 Raport Vjetor 2023, në: [https://idp.al/wp-content/uploads/2024/03/Raporti\\_2023.pdf%20](https://idp.al/wp-content/uploads/2024/03/Raporti_2023.pdf%20)

35 <https://konsultimipublik.gov.al/> , Aksesuar në 10 Shtator 2024

Kontrolli i zbatimit në praktikë	Verifikimi	Vlerësimi	Shënime dhe analiza
	Numri i aktiviteteve të konsultimit publik të pasqyruara në procesverbale/ numrit total të aktiviteteve konsultuese të organizuara.	1 pikë nga 1	<p>Përsëri theksojmë se KDIMDHP nuk ka rolin e hartuesit të projektligjeve. Kështu, institucioni nuk është i ngarkuar me rolin e realizimit të veprimtarive që lidhen me konsultimin publik.</p> <p>Gjithsesi, KDIMDHP ka të dedikuar në faqen e internetit një seksion për dhënie mendimi për projektligjet, dhe në vitin 2024 i ka dërguar mendime 14 institucioneve për projektligje të ndryshme.<sup>36</sup></p> <p>Si institucion mbështetës në proceset e konsultimit publik për Projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 119, datë 14.09.2014, ‘Për të drejtën e informimit’”. Siç parashtrohet në raportin e bërë publik në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike, periudha e konsultimit për këtë ligj ka zgjatur një vit, dhe Ministria e Drejtësisë ka kaluar këtë projektligj përmes një dialogu të vazhdueshëm me KDIMDHP për të diskutuar problematikat dhe për të formuluar parashikimet e duhura ligjore. Konsultimi publik i këtij projektligji është kryer përmes publikimit të tij në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike, dërgimit për mendim disa institucioneve dhe mbajtjes së një takimi konsultativ më 11.04.2023, pas marrjes së mendimeve dhe ripunimit të draftit.<sup>37</sup></p>

36 <https://idp.al/viti-2024-dhenie-mendimi-per-projekt-aktet/>

37 Raport për rezultatet e konsultimit publik. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 119/2014 ‘Për të drejtën e informimit’”, Aktesuar në: <https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/528>, <https://idp.al/2023/04/11/konsultimi-publik-i-ndryshimeve-ne-ligjin-per-te-drejte-e-informimit/>

Kontrolli i zbatimit në praktikë	Verifikimi	Vlerësimi	Shënime dhe analiza
	Numri i komenteve dhe sugjerimeve të marra nga aktivitetet e konsultimit publik të pranuar/kundrejt numrit total të rekomandimeve/sugjerimeve të dhëna gjatë konsultimit publik.	1 pikë nga 1	Gjatë procesit të konsultimit, në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë, rezulton se gjatë vitit ka pasur rreth 20 komente me sugjerime dhe propozime për ndryshimet e reja të projekt-ligjit të hedhur për konsultim. <sup>38</sup> Nga këto komente, 5 janë pranuar ose pranuar pjesërisht, ndërsa 15 janë refuzuar me një argumentim të hollësishëm për arsyet e refuzimit dhe pranimit. <sup>39</sup>
<b>Kontrolli i zbatimit në praktikë</b>		<b>10 pikë nga 10</b>	
<b>Totali i vlerësimit</b>		<b>20 pikë nga 20</b>	

38 Raport i vitit 2023 për procesin e konsultimit publik të realizuar nga Ministria e Drejtësisë. Aksesuar nga: <https://konsultimipublik.gov.al/documents/reports/Raporti%20Vjetor%20i%20Konsultimit%20Publik%202023%20p%C3%ABr%20Ministrin%C3%AB%20e%20Drejt%C3%ABsis%C3%AB.pdf>

39 Raport për rezultatet e konsultimit publik. Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 119/2014 'Për të drejtën e informimit'", <https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/528>, fq. 3-47

## 1.1 KUADRI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL

Llogaridhënia është një ndër aspektet kryesore të mirë-administrimit dhe të integritetit institucional. Ajo është parësore për realizimin e një sërë të drejtash qytetare kundrejt institucioneve publike. KDIMDHP ka rol parësor në lidhje me transparencën në administratën publike në vendin tonë, mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe me procesin e konsultimit publik të hartimit dhe miratimit të akteve ligjore apo strategjike të përgjithshme në vend, të cilat janë aspekte themelore në parimet e administratës publike.

KDIMDHP është një institucion i pavarur dhe e ushtron veprimtarinë bazuar në Ligjin Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, Ligjin Nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, Ligjin Nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, Strategjinë Institucionale 2022-2025 dhe rregulloren e brendshme të institucionit.<sup>40</sup> Ky institucion mbikëqyr zbatimin në praktikë të ligjeve të sipërpërmendura duke bërë të mundur përfundimin e shtetit të së drejtës në rritjen e llogaridhënies dhe detyrimin e institucioneve në përmbushjen e detyrimeve ligjore në fuqi. Programi i Transparencës së KDIMDHP-së i përmban të gjitha elementet sipas Urdhrit Nr. 32, datë 24.03.2021, “Për miratimin e Programit të Transparencës, të rishikuar, të zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale” dhe të gjitha nënrubrikat janë aktive dhe të aksesueshme.

KDIMDHP nuk është një institucion udhëheqës në procesin e konsultimeve publike dhe si rezultat nuk ka të dhëna në Regjistri Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet (RENJK) Publike. Ky institucion ka luajtur një rol mbështetës në proceset e konsultimeve publike, veçanërisht në lidhje me të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale. Megjithatë KDIMDHP nuk është udhëheqës në proceset konsultimit publik, ai ka kontribuar në përmirësimin e projekt-ligjeve përkatëse dhe në mbështetjen e dhënies së mendimeve për projekt-ligje të ndryshme.


## 1.2 KONTROLLI I ZBATIMIT NË PRAKTIKË

KDIMDHP ka hartuar modelin e PT-së sipas përcaktimeve të ligjit për të drejtën e informimit dhe Urdhrit Nr. 32, datë 24.03.2021, “Për miratimin e Programit të Transparencës të Rishikuar të zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale”. PT përmban 13 elemente, të cilat përmbajnë informacione dhe adresa aktive (shih më sipër indeksi ‘Transparenca e Institucionit’). Përsa i përket zbatueshmërisë në praktikë në lidhje me transparencën e institucionit, vlen të theksohet se faqja e internetit është interaktive, e përditësuar dhe i ka të publikuara rregulloret dhe të gjitha elementet të cilat sigurojnë transparencë dhe akses të lehtë për qytetarët në informacionet zyrtare. Sa i përket transparencës financiare, në faqen e internetit ka të publikuara raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit.

Vlen të theksohet se gjithashtu, bazuar në analizën e regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve, Komisioneri ka plotësuar kriterin e numrit mesatar të ditëve për kthimin e përgjigjes ndaj kërkesave për informacion. Mesatarja e kthimit të përgjigjeve është 8.5 për vitin 2024 (deri në datën 15.9.2024), në vitin 2023 është 8.6 ditë, dhe për vitin 2022 mesatarja e kthimit të përgjigjes është 5 ditë. Për të tre këto vite institucioni vlerësohet me një mesatare të kthimit të përgjigjes së kërkesave prej 7.36 ditësh nga data e marrjes së kërkesës. Shih grafikun 3.


40 Shih <https://idp.al/rreth-nesh/>

**Grafik Nr. 3: Mesatarja e kërkesave që kanë marrë përgjigje**



KDIMDHP informon në mënyrë të vazhdueshme publikun mbi veprimtarinë e saj. Rubrikat 'Njoftime për Shtyp' dhe 'Aktivitete të Zyrës së Komisionerit' përditësohen në kohë reale, me një mesatare prej 7.4 njoftime/aktivitete në total për çdo muaj gjatë vitit 2023, dhe 7.4 njoftime/aktivitete në total në muaj gjatë vitit 2024. Shih grafikët 4 dhe 5.

**Grafiku 4. Numri i aktiviteteve në vitet 2023-2024**    **Grafiku 5. Numri i njoftimeve në vitet 2023-2024**



## 1.3 REKOMANDIME PËR LLOGARIDHËNIEN

Në kuadër të përmirësimit të llogaridhënies, rekomandohet që:

- Institucioni të vazhdojë punën në procesin e monitorimit të brendshëm dhe të institucioneve të tjera, për të forcuar llogaridhënien në bazë të Programit të Transparencës;
- Institucioni të vazhdojë përditësimin e faqes së internetit me informacione lehtësisht të arritshme për publikun;
- Të krijohet një nënrubrikë e posaçme për mbështetjen që institucioni jep në proceset e konsultimit publik;
- Institucioni të vlerësojë krijimin e një platforme më efikase për menaxhimin e kërkesave, e cila mund të përfshijë edhe ofrimin e statistikave periodike për këto ankesa.



## 2. INDEKSI I INTEGRITETIT – TRANSPARENCA PROAKTIVE

Kontrolli ligjor dhe institucional	Verifikimi	Vlerësimi	Shënime dhe analiza
<b>Mekanizmat e llogaridhënies</b>	Programi i Transparencës përmban planin vjetor dhe raportin vjetor të institucionit publik të miratuar.	1 pikë nga 1	Programi i Transparencës (PT) dhe faqja e internetit e institucionit përmbajnë raportin vjetor të vitit 2023, <sup>41</sup> të miratuar nga Kuvendi me Rezolutën 'Për vlerësimin e vepërimitarisë së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2023'. <sup>42</sup> Institucioni ka publikuar në faqen e tij të internetit: Strategjinë Institucionale 2022-2025 dhe Planin e Veprimt, <sup>43</sup> Raportin e Monitorimit të Strategjisë Institucionale të Zyrës së Komisionerit për vitin 2023 <sup>44</sup> , Programin e Punës për vitin 2024, si dhe Programin e Punës për vitin 2023 të përditësuar me rezultatet e arritura <sup>45</sup> , rregulloren e brendshme të institucionit të miratuar <sup>46</sup> , buxhetin e detajuar për vitet 2024-2026, Planin Buxhetor Afatmesëm dhe Raportin e Monitorimit të PBA-së për periudhat janar-prill 2023, janar-gusht 2023, janar-dhjetor 2023, dhe janar-prill 2024, së bashku me relacionin. <sup>47</sup> Janë publikuar edhe regjistrat e parashikimeve të prokurimit publik dhe regjistrat e realizimit të prokurimeve publike për vitin 2023 dhe për vitin 2024, të përditësuara deri në korrik 2024. <sup>48</sup>

41 [https://idp.al/programi\\_i\\_transparences/](https://idp.al/programi_i_transparences/)

42 [https://idp.al/wp-content/uploads/2024/07/rezoluta\\_kuvendi\\_2023.pdf](https://idp.al/wp-content/uploads/2024/07/rezoluta_kuvendi_2023.pdf)

43 <https://idp.al/strategji-2022-2025/>

44 [https://idp.al/wp-content/uploads/2024/07/RAPORTIM-PERIODIK-2023\\_Strategjia-Institucionale-2022\\_2025-final.pdf](https://idp.al/wp-content/uploads/2024/07/RAPORTIM-PERIODIK-2023_Strategjia-Institucionale-2022_2025-final.pdf)

45 <https://idp.al/programi-i-punes/>

46 [https://idp.al/programi\\_i\\_transparences/#](https://idp.al/programi_i_transparences/#)

47 Shih në: <https://idp.al/buxheti-i-zyres-se-komisionerit/> dhe <https://idp.al/wp-content/uploads/2024/06/1.Raporti-Permbledhes-i-Shpenzimeve-te-MinistriseInstitucionit-Buxhetor.xlsx>

48 <https://idp.al/buxheti-i-zyres-se-komisionerit/>

Kontrolli ligjor dhe institucional	Verifikimi	Vlerësimi	Shënime dhe analiza
	Evidentohen dalime në zbatimin e aktiviteteve (krahasuar me planin). Në raportin vjetor të monitorimit të buxhetit, raporti fakt/plan është >85%.	1 pikë nga 1	Nisur nga takimi <sup>49</sup> me Drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme dhe Financës dhe bazuar në raportin e monitorimit të performancës së produkteve/ shërbimeve për periudhën janar-dhjetor 2023, institucioni ka realizuar planin vjetor të buxhetit (të rishikuar) në masën 98.1%. <sup>50</sup> Ky raport reflektohet edhe në raportin vjetor të institucionit në Kuvend, ku pjesën më të madhe të realizimit faktik të buxhetit për vitin 2023 e zënë pagat, me 64% të tij që shkon për pagat e punonjësve. <sup>51</sup>
<b>Auditi i jashtëm</b>	Institucioni ka kaluar një auditim të jashtëm (KLSH/Autoritete Mbikëqyrëse/ BE/ Auditues të Pavarur) në tre vitet e fundit	1 pikë nga 1	KDIMDHP ka kaluar një kontroll për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në këtë institucion nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil (KMSHC). Projekt-raporti është publikuar në prill 2024 në faqen e KDIMDHP-së. Sipas këtij raporti, konstatohet se KDIMDHP ka respektuar kërkesat e ligjit në proceset e organizimit dhe funksionimit në administrimin e shërbimit civil, siç mund të përmendet respektimi i kërkesave ligjore për hartimin e formularit të përshkrimit të punës dhe procedurat e ndjekura nga institucioni, etj. <sup>52</sup> Në vitin 2021, KDIMDHP ka kaluar një audit nga 'Audit Agency for EU-Accredited Assistance Program' (Agjenci auditit për programet e asistencës të akredituar nga BE) lidhur me projektin me nr. reference AA-IPA 1/IPAII-2021-04-SA-1, 'On the Assurance Regarding the Effective Functioning of the Management and Control Systems' ("Për sigurinë lidhur me funksionimin efektiv të sistemeve të menaxhimit dhe kontrollit"). KDIMDHP ka kaluar këtë proces me vlerësimin: 'HIPAU in IDP (KDIMDH)] – Works well, only minor improvements needed – category one' (punon mirë, ka nevojë vetëm për disa përmirësime të vogla – kategoria një).

49 Takimi i realizuar në datën 10 korrik 2024 në zyrat e KDIMDHP-së.

50 <https://idp.al/wp-content/uploads/2024/02/RELACION-MBI-MONITORIMIN-janar-dhjetor-2023.pdf>

51 Raporti Vjetor 2024, fq 49-50.

52 <https://idp.al/wp-content/uploads/2024/07/Raport-KMSHC.pdf>

Kontrolli ligjor dhe institucional	Verifikimi	Vlerësimi	Shënime dhe analiza
			<p>Ky raport u vu në dispozicion ekspertëve më datë 10 maj 2024 dhe gjendet pjesërisht i publikuar (vetëm për vlerësimin e bërë ndaj institucionit) në faqen e internetit të KDIMDHP-së.<sup>53</sup> Për sa i përket auditit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH), në faqen e institucionit është i publikuar raporti i auditimit i vitit 2015.</p> <p>KDIMDHP ka pasur auditimin financiar dhe të përputhshmërisë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit për periudhën 01.01.2021-31.12.2023. Gjatë përfundimit të këtij raporti monitorimi të Indeksit të Integritetit të Institucionit, KLSH ka paraqitur Raportin e Auditimit pranë KDIMDHP-së,<sup>54</sup> ndërsa procesi i shqyrtimit të rekomandimeve të këtij Raporti do të vijojë më tej.</p> <p>KDIMDHP, në datat 25-28 tetor 2022, ka kaluar një vlerësim 'peer review' (kontroll homolog) nga Thematic Support Unit 'TAIEX Instrument' (njësia e mbështetjes tematike), i mbështetur nga BE për funksionimin efektiv të institucioneve të pavarura. Në këtë vlerësim (të vënë në dispozicion me email nga Zyra e Komisionerit), raportohet se rekomandimet e Komisionerit lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale kanë ndikim më të madh në sektorin privat sesa në atë publik. Po ashtu, Komisioneri ka pak kapacitete për të mbuluar ngarkesën e punës, dhe rritja e kapaciteteve është e nevojshme. Roli dhe pozita e tij duhet të forcohen për të adresuar në mënyrë efektive çështjet që ai trajton (fq. 18).<sup>55</sup></p>
	<p>Raporti i Auditimit të fundit të jashtëm është i publikuar nga institucioni, duke përfshirë edhe listën e rekomandimeve.</p>	<p>1 pikë nga 1</p>	<p>Në faqen e internetit të institucionit janë bërë publike dy audite të jashtme: kontroll për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil të bërë nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil (shih draft-raporti e publikuar në prill 2024) dhe raporti i auditimit nga Agjencia e Auditit për Programet e Asistencës të Akredituar nga BE në vitin 2021. Në të dyja rastet nuk ka rekomandime të lëna për institucionin.<sup>56</sup></p>

53 <https://idp.al/wp-content/uploads/2024/07/Raporti-i-Auditimit-te-Jashtem.pdf>

54 Shih auditimet që janë për anashkalim, fq. 1, në: <https://panel.klsh.org.al/storage/phpyTPsBH.pdf>

55 [https://idp.al/wp-content/uploads/2024/07/ENGLISH\\_Raporti\\_2023.pdf](https://idp.al/wp-content/uploads/2024/07/ENGLISH_Raporti_2023.pdf)

56 <https://idp.al/auditimi/>

Kontrolli ligjor dhe institucional	Verifikimi	Vlerësimi	Shënime dhe analiza
	Institucioni ka përgatitur planin e adresimit të rekomandimeve bazuar në raportin e fundit të auditimit të jashtëm.	1 pikë nga 1	Institucioni ka një Plan për adresimin e rekomandimeve të auditimit të jashtëm të bërë nga Agjencia e Auditit për Programet e Asistencës të Akredituar nga BE për projektin AA-IPA 1/IPAII-2021-04-SA-1, 'Për sigurinë lidhur me funksionimin efektiv të sistemeve të menaxhimit dhe kontrollit'. Plani i veprimit mbi raportin e auditimit të ushtruar pranë KDIMDHP për njësinë IPA me Nr. Prot. 44/3 i datës 26 janar 2021 u vu në dispozicion gjatë takimeve në kopje të fotokopjuar dhe u dërgua elektronikisht.
<b>Audit i Brendshëm</b>	Dokumenti i Kartës së Auditimit (statusi i organizatës, qëllimi, misioni, objektivat e punës, llogaridhënia dhe përgjegjësitë e njësisë së auditimit të brendshëm) është hartuar dhe miratuar.	1 pikë nga 1	Nuk aplikohet, për shkak të numrit të vogël të punonjësve referuar strukturës së institucionit.
	Rregullat e sjelljes dhe parimet që duhet të udhëheqin punën e auditorëve të brendshëm si dhe plani i punës janë hartuar, miratuar dhe vënë në zbatim.	1 pikë nga 1	Në takimet e zhvilluara në institucion na u komunikua se Komisioneri e ka trajtuar çështjen e auditit të brendshëm në respektim të ligjit për auditin e brendshëm në sektorin publik, duke u nisur nga tërësia e veprimtarisë dhe madhësisë së institucionit. <sup>57</sup> Ky tregues nuk aplikohet, për shkak të numrit të vogël të punonjësve sipas strukturës së institucionit Gjithsesi, na u vu në dispozicion një marrëveshje që KDIMDHP ka lidhur me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në përputhje me ligjin për auditin e brendshëm në sektorin publik, me Nr. Prot. 736/2, datë 1.7.2019 (KDIMDHIP) dhe Nr. Prot. 7349/3, datë 9.7.2019 (MBZHR) në përputhje me nenin 10 të ligjit për auditin e brendshëm, vetëm për një çështje me rëndësi për institucionin.

57 Ligji Nr. 114/2015, "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", i ndryshuar. <http://qbz.gov.al/eli/ligj/2015/10/22/114>

Kontrolli ligjor dhe institucional	Verifikimi	Vlerësimi	Shënime dhe analiza
<b>Matja e kënaqshmërisë së klientit</b>	Ekziston një sistem i monitorimit të vazhdueshëm të kënaqësisë së klientit, ka evidenca se gjetjet e këtij vlerësimi janë të përfshira në planin operativ/programin e punës.	0 pikë nga 1	<p>Në takimet e zhvilluara me përfaqësues të institucionit, u konfirmua se mekanizmi kryesor i monitorimit të vazhdueshëm të kënaqësisë së klientit është 'Dosja e falënderimeve' dhe komunikimet përmes adresës elektronike të institucionit. Gjatë takimeve në Zyrën e Komisionerit u ndanë të dhëna që datojnë që nga viti 2020, të cilat dëshmojnë për kënaqësinë e marrjes së shërbimit nga KDIMDHP dhe punën efektive të këtij institucioni.</p> <p>Më tej, me hyrjen në fuqi të ndryshimeve të ligjit për të drejtën e informimit, një nga detyrimet e shtuara për autoritetet publike është raportimi çdo vit në lidhje me statistikat vjetore, sipas formatit të miratuar nga Komisioneri. Në formatin e vitit 2023 një nga pikat që kërkohej të raportonte Koordinatori për të Drejtën e Informimit ishte: "A ka ndonjë temë për të cilën do të dëshironit që Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale të japë informacion apo udhëzim?" Për sa më sipër, koordinatorët plotësuan pyetësonin dhe rezultatet e tij u mbledhën në një dokument. Në hartimin e planit të punës për vitin 2024 Drejtoria e Përgjithshme e të Drejtës për Informim, mbajti parasysh kërkesat e koordinatorëve dhe planifikoi trajnime të dedikuara për to, të cilat gjithashtu i ka realizuar. Në këto trajnime u diskutuan temat e kërkuara nga ana e koordinatorëve. KDIMDHP ndau me ekspertët kopje të dokumentit me kërkesat e koordinatorëve si dhe planin e punës së Zyrës së Komisionerit.</p> <p>Pavarësisht këtyre përpjekjeve, institucioni nuk rezulton të ketë një sistem monitorimi të vazhdueshëm të kënaqësisë së klientit.</p>
	Të sigurohen evidenca se gjetjet e këtij vlerësimi janë të përfshira në planin operativ/programin e punës.	1 pikë nga 2	Bazuar në takimet dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion, mekanizmi i vlerësimit të klientëve ose përfituesve të shërbimeve të Zyrës së Komisionerit edhe pse përcaktohet në Programin e Punës për vitin 2024, është në kuadër të 'Konferencës së XV Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit', e mbajtur më datat 3-5 qershor 2024 në Tiranë, ku një nga detyrat është përfundimi i të gjitha aktiviteteve pas konferencës dhe finalizimi i dokumenteve të sondazhit të vlerësimit të organizimit të konferencës. <sup>58</sup> Po ashtu, 'Dosja e falënderimeve' është një dokument që përdoret vetëm nëse subjektet janë të pranishëm në mjediset e KDIMDHP-së.
<b>Kontrolli ligjor dhe institucional</b>		<b>8 pikë nga 10</b>	

58 Programi i Punës 2024, fq. 5 [https://idp.al/wp-content/uploads/2024/01/programi\\_i\\_punes\\_2024.pdf](https://idp.al/wp-content/uploads/2024/01/programi_i_punes_2024.pdf)

Kontrolli i zbatimit në praktikë	Verifikimi	Vlerësimi	Shënime dhe analiza
<b>Funksionaliteti i mekanizmave të llogaridhënies horizontale dhe vertikale</b>	Institucioni ka të paktën një autoritet mbikëqyrës, në të cilin raporton në mënyrë periodike.	1 pikë nga 1	<p>Autoriteti mbikëqyrës i KDIMDHP-së është Kuvendi, të cilit i raporton çdo vit për aktivitetin e tij. Bazuar në raportimin e fundit të vitit 2023,<sup>59</sup> Kuvendi, në Rezolutën e tij 'Për Vlerësimin e Veprimtarisë së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për Vitin 2023',<sup>60</sup> vlerëson rolin e veçantë të Zyrës së Komisionerit në qasjen për formimin e kulturës së garantimit të standardeve më të larta në ushtrimin praktik të së drejtës për informim dhe mbrojtjen e të dhënave personale.</p> <p>Një tjetër institucion mbikëqyrës është ILDKPKI, ku KDIMDHP ka caktuar si autoritet përgjegjës znj. LM. me Urdhrin Nr. 134, datë 25 gusht 2014, në zbatim të detyrave për parandalimin, trajtimin dhe zgjidhjen e konflikteve, si dhe për çdo përgjegjësi tjetër.<sup>61</sup></p>
	Institucioni përgatit të paktën një raport vjetor, i cili shqyrtohet dhe miratohet nga autoriteti mbikëqyrës i tij dhe bëhet publik.	1 pikë nga 1	KDIMDHP i raporton çdo vit Kuvendit të Shqipërisë. Raportet vjetore të institucionit janë publike në faqen e institucionit, së bashku me rezolutat e Kuvendit për çdo vit. <sup>62</sup> Raporti vjetor i vitit 2023 është miratuar nga Kuvendi më 4.7.2024, ku është theksuar zbatimi i të gjitha rekomandimeve të lëna në rezolutën e datës 8.7.2023. <sup>63</sup>

59 [https://idp.al/wp-content/uploads/2024/03/Raporti\\_2023.pdf%20](https://idp.al/wp-content/uploads/2024/03/Raporti_2023.pdf%20)

60 [https://idp.al/wp-content/uploads/2024/07/rezoluta\\_kuvendi\\_2023.pdf](https://idp.al/wp-content/uploads/2024/07/rezoluta_kuvendi_2023.pdf)

61 Urdhër Nr. 134, datë 25 gusht 2014 "Për Caktimin e Autoritetit Përgjegjës", Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (vënë në dispozicion i fotokopjuar)

62 <https://idp.al/raporte-vjetore/>

63 [https://idp.al/wp-content/uploads/2024/07/rezoluta\\_kuvendi\\_2023.pdf](https://idp.al/wp-content/uploads/2024/07/rezoluta_kuvendi_2023.pdf)

Kontrolli i zbatimit në praktikë	Verifikimi	Vlerësimi	Shënime dhe analiza
	<p>Institucioni përgatit nëpërmjet ekspertëve të jashtëm raport të monitorimit të planit vjetor ose strategjisë sektoriale (të paktën njëherë në tre vjet).</p>	<p>2 pikë nga 2</p>	<p>KDIMDHP ka disa raporte periodike, të cilat lidhen me monitorimin e planit vjetor, punës së institucionit, strategjisë sektoriale, apo zbatimit të planit të integritetit të Komisionerit. Këto raporte monitorimi janë përgatitur nga institucioni, siç edhe është konfirmuar gjatë takimeve të zhvilluara me përfaqësues të këtij institucioni.</p> <p>Në Raportin e Monitorimit të Zbatimit të Planit të Integritetit, i publikuar në vitin 2023, bëhet një vlerësim i përputhshmërive dhe arritjeve të objektivave gjatë vitit të parë të zbatimit të tij.<sup>64</sup> Edhe raporti i monitorimit të Programit të Punës së institucionit për vitin 2023 është bërë publik në faqen e institucionit.<sup>65</sup></p>
	<p>Nga vlerësimi i raportit të zbatimit të rekomandimeve të auditimit të jashtëm të fundit rezulton se 80% e rekomandimeve janë adresuar nga një plan veprimi të miratuar dhe bërë publik.</p>	<p>2 pikë nga 2</p>	<p>Nga analiza e auditimit të jashtëm të fundit rezulton se auditimi nga KLSH është kryer këtë vit, por raporti ende nuk është publikuar. Ndërkohë, nga draft raporti i Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil nuk janë gjetur shkelje dhe, për pasojë, nuk janë dhënë rekomandime, siç është përmendur më lart.</p>

64 [https://idp.al/wp-content/uploads/2024/07/raporti\\_i\\_monitorimit\\_te\\_planit\\_te\\_integritetit.pdf](https://idp.al/wp-content/uploads/2024/07/raporti_i_monitorimit_te_planit_te_integritetit.pdf)

65 <https://idp.al/wp-content/uploads/2024/01/Plani-i-Punes-2023-31.01.2023.pdf>

Kontrolli i zbatimit në praktikë	Verifikimi	Vlerësimi	Shënime dhe analiza
	Nga vlerësimi i raportit të zbatimit të rekomandimeve të auditimit të brendshëm (i një viti më përpara) rezulton se 80% e rekomandimeve janë adresuar nga një plan veprimi të institucionit.	2 pikë nga 2	Sipas shpjegimit të mësipërm, institucioni ka hartuar vetëm një raport të auditimit të brendshëm të realizuar në bazë të marrëveshjes me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (shih më sipër). Referuar këtij raporti, janë lënë rekomandime për trajtimin e të cilave është hartuar plani përkatës i realizimit të tyre. <sup>66</sup>
	Ka dispozita të shumta për të siguruar që institucioni realizon përgjegjësitë e tij të prokurimit publik në mënyrë të ligjshme dhe etike. Institucioni publikon Planin e Prokurimeve (0.5 pikë).	0.5 pikë nga 0.5	Zyra e Komisionerit ka në faqen e internetit, në seksionin 'Buxheti i Zyrës së Komisionerit', regjistrin e parashikimeve të prokurimeve publike dhe regjistrin e realizimit të prokurimeve publike të përditësuar deri më 4 korrik 2024. <sup>67</sup> Për sa i përket vitit 2023, është bërë deklarimi i regjistrit të parashikimeve të prokurimeve publike dhe regjistrit të realizimit të prokurimeve publike në raportin e monitorimit mbi performancën e produkteve/shpenzimeve për periudhën janar-dhjetor 2023. Nga ky raport rezulton se janë zhvilluar 34 procedura prokurimi, të gjitha të suksesshme, me fitues dhe plotësim të kërkesave. <sup>68</sup>
	Raporti mes planit/faktit të prokurimeve është mbi 50%.	0.5 pikë nga 0.5	Vlen të theksohet se raporti midis planit dhe realizimit faktik të prokurimeve për vitin 2023 është rreth 80.6%. Përqindja e realizimit të planit të prokurimeve për vitin 2024 është 70.19%, bazuar në regjistrin e publikuar në faqen e internetit të institucionit (të dhënat janë përditësuar më 14 shtator). <sup>69</sup>

66 Shih planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve (MESIA IPA - KDMDHP) në: [https://idp.al/wp-content/uploads/2024/10/Scan2024-09-19\\_154418.pdf](https://idp.al/wp-content/uploads/2024/10/Scan2024-09-19_154418.pdf)

67 [https://idp.al/wp-content/uploads/2024/07/WF\\_ProcurementPlan-28-P.docx](https://idp.al/wp-content/uploads/2024/07/WF_ProcurementPlan-28-P.docx), [https://idp.al/wp-content/uploads/2024/07/WF\\_ProcurementPlanExecution-21R.docx](https://idp.al/wp-content/uploads/2024/07/WF_ProcurementPlanExecution-21R.docx)


68 <https://idp.al/wp-content/uploads/2024/02/RELACION-MBI-MONITORIMIN-janar-dhjetor-2023.pdf>

69 [https://idp.al/wp-content/uploads/2024/07/WF\\_ProcurementPlan-28-P.docx](https://idp.al/wp-content/uploads/2024/07/WF_ProcurementPlan-28-P.docx), [https://idp.al/wp-content/uploads/2024/07/WF\\_ProcurementPlanExecution-21R.docx](https://idp.al/wp-content/uploads/2024/07/WF_ProcurementPlanExecution-21R.docx)



Kontrolli i zbatimit në praktikë	Verifikimi	Vlerësimi	Shënime dhe analiza
	Raporti prokurime të drejtpërdrejta (në vlerë)/ totalit të prokurimeve është <25% (0.5 pikë).	0.5 pikë nga 0.5	Në regjistrin e parashikimeve të prokurimit publik për vitin 2023 dhe, për rrjedhojë, edhe në realizimet, janë krijuar 34 zëra për shpenzime, nga të cilat 23 janë blerje me vlera mbi 100.000 lekë dhe 11 prokurime janë nën vlerën 100.000 lekë. Sa i përket vlerës absolute të prokurimeve, sqarojmë se totali i prokurimeve është 24.780.000 lekë, pa TVSH. Vlera e prokuruar mbi 100.000 lekë është 16.730.000 lekë, pa TVSH, e realizuar me procedurë blerje të vogël ose sistem dinamik (bileta), ku pesha specifike përkundrejt totalit në vlerë është 67%. Vlera e prokuruar me procedurë blerjeje nën 100.000 lekë është 1.100.000 lekë, pa TVSH, me një peshë specifike prej 4%. Vlera e prokuruar me procedurë tenderi të hapur është 6.950.000 lekë, pa TVSH, me një peshë specifike prej 28%. Pra, blerjet nën 100.000 lekë janë modeste, duke përfaqësuar vetëm 4% të totalit të prokurimeve. <sup>70</sup> Shih grafikun 6 më poshtë:
	Raporti numri i kontratave me probleme/ totalit të kontratave është <25% (0.5 pikë).	0.5 pikë nga 0.5	Bazuar në Regjistrin e Realizimit të Prokurimit Publik për vitin 2023, nuk ka raportime për ndonjë kontratë me probleme. <sup>71</sup>
<b>Kontrolli i zbatimit në praktikë</b>		<b>10 pikë nga 10</b>	
<b>Totali i vlerësimit</b>		<b>18 pikë nga 20</b>	

**Grafiku 6. Peshë specifike e prokurimeve sipas procedurës në %**



70 <https://idp.al/wp-content/uploads/2024/02/Regjistri-i-realizimeve-te-prokurimit-publik.pdf>

71 <https://idp.al/wp-content/uploads/2024/02/Regjistri-i-parashikimeve-te-prokurimit-publik-1.pdf>


## 2.1 KUADRI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL

Bazuar në mekanizmat e llogaridhënies dhe kriteret e vlerësimit të indeksit të transparencës proaktive të institucionit vlen të theksohet se KDIMDHP ka të publikuar në faqen e tij të gjitha informacionet e kërkuara nga kriteri i mekanizmit të llogaridhënies duke filluar që nga strategjia institucionale, raportet vjetore, rezolutat e Kuvendit, dokumente në lidhje me funksionimin e Kuvendit, etj., (Programi i Transparencës përmban planin vjetor dhe raportin vjetor të institucionit publik të miratuar). Nga përmbushja e kriterit të kuadrit ligjor dhe institucional vlen të theksohet se ky institucion nuk ka një audit të brendshëm dhe, si pasojë, as dokumentin e kartës së auditimit për shkak të numrit të vogël të punonjësve referuar strukturës së institucionit. Gjatë takimeve të bëra në institucion, na u komunikua se Komisioneri e ka trajtuar çështjen e auditit të brendshëm në një formë ad hoc në përputhje me legjislacionin në fuqi. Nga vlerësimi i bërë për institucionin për sistemin e monitorimit të vazhdueshëm të kënaqësisë së klientit vlen të theksohet se ky monitorim nuk realizohet përmes një sistemi monitorimi të vazhdueshëm, si dhe qasjet që përdor, janë të shpërqendruara apo të atilla që kërkojnë praninë fizike në institucion. Pas vlerësimit të këtij institucioni, vlen të theksohet se mungon kuadri institucional i rregullimit të sistemit të vlerësimit të kënaqësisë së klientit, por janë siguruar evidenca që matin kënaqësinë e klientit.

## 2.2 KONTROLLI I ZBATIMIT NË PRAKTIKË

Nga kontrolli i zbatimit në praktikë të realizimit të buxhetit vjetor të institucionit rezulton se ky institucion në raportin e monitorimit të buxhetit e ka realizuar planin vjetor të tij në masën 98.1%. Gjithashtu, përsa i përket realizimit të prokurimeve, institucioni ka realizuar planin e parashikimeve të prokurimeve publike për vitin 2023 ishte në masën 80.6%, dhe për vitin 2024 është planifikuar të realizohet në 70.19%. Vlera absolute e prokurimeve është publikuar dhe e ndarë sipas kategorive të ndryshme. Shih grafikun 7.

Grafiku 7. Realizimi i planit të prokurimit publik



Bazuar në dokumentacionin e bërë publik dhe të vënë në dispozicion, ky institucion ka pasur auditime të jashtme nga autoritete si Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil dhe agjencitë e BE-së, duke treguar përputhshmëri me standardet ligjore, me vetëm disa rekomandime të vogla për përmirësime. I vetmi kontroll që ka lënë rekomandime është vlerësimi 'peer review' (kontrolli nga njësi homologe) i bërë nga Njësia e Mbështetjes Tematike e instrumentit TAIEX (Thematic Support Unit 'TAIEX Instrument'),

Komisioni Evropian, për funksionimin efektiv të institucioneve të pavarura. Në këtë vlerësim, raportohet se rekomandimet e Komisionerit lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale kanë pasur një ndikim më të madh në sektorin privat sesa në atë publik, si dhe theksohet se Komisioneri ka pak kapacitete për të mbuluar ngarkesën e punës, dhe është e nevojshme të rriten kapacitetet e këtij institucioni. Roli dhe pozita e tij rekomandohet të forcohen për të trajtuar sa më plotë dhe sa më mirë çështjet që janë kompetencë e Komisionerit.

## 2.3 REKOMANDIME PËR TRANSPARENCËN PROAKTIVE

Në kuadër të përmirësimit të transparencës proaktive rekomandohet që:

- Institucioni të krijojë një mekanizëm institucional të matjes së vazhdueshme të kënaqësisë së klientit dhe t'i përfshijë këto evidenca në planin e punës së vitit pasardhës;
- Të vlerësohet mundësia e krijimit të një njësie të brendshme auditimi, nisur nga rëndësia strategjike që ka ky institucion;
- Për shkak se faqja e internetit e KDIMDHP-së, edhe pse ka një nivel të lartë transparence, nuk ka aksesueshmërinë e kërkuar ligjore për personat me individët me aftësi të kufizuar dhe rekomandohet vendosja e mekanizmave për përdoruesit e këtij grupimi shoqëror.

### 3. INDEKSI I INTEGRITETIT - QASJA STRATEGJIKE

Kontrolli ligjor dhe institucional	Verifikimi	Vlerësimi	Shënime dhe analiza
<b>Planifikimi i operacioneve të institucionit</b>	Institucioni ka të publikuar Planin e Zhvillimit Strategjik të institucionit dhe Planin e Veprimit.	2 nga 2	<p>KDIMDHP ka hartuar, miratuar dhe publikuar strategjinë 2022-2025. Kjo strategji është vijim i Strategjisë së Zhvillimit Institucional 2021-2023 të miratuar më parë nga institucioni. Në të përfshihen objektivat për secilën fushë të veprimtarisë së institucionit, si dhe masat e aktivitetet konkrete që do të realizohen në periudhën e kohështrirjes së strategjisë. Strategjia shërben edhe si një instrument programimi dhe monitorimi i aktiviteteve për përmbushjen e çdo objekti të parashikuar në të.</p> <p>Strategjia shoqërohet nga Plani i Veprimit 2022-2025, i cili shërben si një instrument programimi dhe monitorimi i aktiviteteve për përmbushjen e çdo objekti të parashikuar në këtë Strategji. Edhe Strategjia e dytë, Nr. Prot. 1716/1, datë 8.10.2022 shoqërohet me planin e masave.<sup>72</sup> KDIMDHP mban procesverbale gjatë hartimit të këtyre dokumenteve: gjatë takimit me institucionin nga ekspertët është administruar një kopje e procesverbalit për hartimin e strategjisë institucionale dhe të strategjisë së riskut (të ndryshuar) për vitet 2022-2025.</p> <p>Institucioni ka të miratuar Strategjinë e Menaxhimit të Riskut 2022-2025 dhe Planin e Masave për minimizimin e risqeve. Kjo Strategji është miratuar nga mbledhja e GMS, datë 5.10.2022. Plani i Veprimit të Strategjisë është pjesë përbërëse e saj:</p> <p>KDIMDHP ka miratuar edhe programe pune, të cilat, prej vitit 2016 e në vijim, i ka të publikuara: janar-dhjetor 2024.<sup>73</sup></p>

72 <https://www.idp.al/strategjia-2021-2023/>, [https://idp.al/wp-content/uploads/2024/02/Strategjia\\_Institucionale\\_2022\\_2025\\_final.pdf](https://idp.al/wp-content/uploads/2024/02/Strategjia_Institucionale_2022_2025_final.pdf), dhe në <https://idp.al/strategji-te-kdimdp/> janë strategjitë e mëparshme të institucionit.

73 <https://idp.al/programi-i-punes/> si dhe : [https://idp.al/wp-content/uploads/2024/01/programi\\_i\\_punes\\_2024.pdf](https://idp.al/wp-content/uploads/2024/01/programi_i_punes_2024.pdf)

Kontrolli ligjor dhe institucional	Verifikimi	Vlerësimi	Shënime dhe analiza
Institucioni ka të publikuara Procedurat Standarde të Veprimit (PSV) ose gjurmët e auditimit për proceset e punës së institucionit	1 nga 2	<p>KDIMDHP ka hartuar dhe miratuar një sërë procedurash standarde të veprimit për kryerjen e disa procedurave. Në listën e printuar e procedurave standarde të veprimit (PSV) që institucioni ka hartuar, përfshihen:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>■ Lista e proceseve për marrjen në dorëzim;</li> <li>■ Harta e procesit të kryerjes së pagesave e miratuar në 2022;</li> <li>■ Harta e administrimit të sistemit të regjistrimit audio dhe video gjatë zhvillimit të seancave dëgjimore; administrimi i faqes zyrtare të internetit dhe mbulimi mediatik i aktiviteteve të institucionit;</li> <li>■ Hartimi i programit buxhetor afatmesëm; administrimi i procedurave të prokurimit 'Blerje me vlerë të vogël'; 'Blerje direkte me vlerë nën 100.000 lekë';</li> <li>■ Harta e procesit të menaxhimit të burimeve njerëzore;</li> <li>■ Harta e procesit të blerjeve direkte pa prokurim, nën 100.000 lekë;</li> <li>■ Harta e procesit të menaxhimit të dorëzimit të deklaratave të pasurisë nga ana e subjekteve deklarues.</li> <li>■ Zbatimi i rekomandimeve të lëna në Rezolutën e Kuvendit,<sup>74</sup> etj.</li> </ul> <p>KDIMDHP, në takimin e datës 5 korrik 2024, informoi se dy procedura standarde janë planifikuar të realizohen me mbështetjen e zyrës së OSBE-së.</p> <p>Disa prej PSV-ve të mësipërme janë të publikuara në faqen e institucionit, por jo të gjitha.<sup>75</sup></p>	

74 Nga institucioni u vu në dispozicion Procesverbal me \*Nr.prot 1716/1.

75 <https://idp.al/wp-content/uploads/2024/08/Gjurmët-e-auditimit.pdf>

Kontrolli ligjor dhe institucional	Verifikimi	Vlerësimi	Shënime dhe analiza
	Institucioni ka të publikuar një raport monitorimi të zbatimit të Planit Strategjik të Institucionit	2 nga 2	<p>KDIMDHP është e angazhuar për monitorimin dhe raportimin e strategjisë. Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS), i ngritur me Urdhrin e Komisionerit Nr. 231 datë 29.12.2023 “Për miratimin e Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS) dhe ekipit të Menaxhimit të Programit (EMP) për vitin 2023”, ka hartuar raportin periodik 1-vjeçar të monitorimit të zbatimit të Strategjisë për vitin 2023. Raporti, i publikuar në faqen zyrtare të internetit të institucionit, thekson se 87.1% e masave për vitin 2023 janë realizuar.<sup>76</sup></p> <p>Me Urdhër Nr. 93, datë 19.12.2023 “Për miratimin e Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS) dhe ekipit të Menaxhimit të Programit (EMP) për vitin 2024” u ngrit GMS për vitin 2024.</p> <p>KDIMDHP ka publikuar në faqen e internetit Raportin e monitorimit mbi performancën e produkteve/shpenzimeve për periudhën Janar- Prill 2024.<sup>77</sup></p>
<b>Planifikimi i menaxhimit të integritetit</b>	Institucioni ka të publikuar Planin e Integritetit, të miratuar dhe përditësuar.	1 nga 1	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale me Urdhrin Nr. 160, datë 28.09.2022 ka miratuar Planin e Integritetit 2022–2025, dhe e ka publikuar atë në faqen e vet të institucionit. <sup>78</sup> Ky plan, i vlerësuar nga institucioni si një instrument përgjegjshmërie dhe transparence për publikun, është hartuar në bashkëpunim me shoqërinë civile dhe mbështetjen e partnerëve të huaj në vendin tonë. <sup>79</sup>

76 Raportim periodik, Strategjia Institucionale 2022 – 2025, në: [https://idp.al/wp-content/uploads/2024/07/RAPORTIM-PERIODIK-2023\\_Strategjia-Institucionale-2022\\_2025-final.pdf](https://idp.al/wp-content/uploads/2024/07/RAPORTIM-PERIODIK-2023_Strategjia-Institucionale-2022_2025-final.pdf)

77 Shih raportin e monitorimit mbi performancën e produkteve/shpenzimeve për periudhën janar-prill 2024 të GMS/EMP-së, KDIMDHP, në: <https://idp.al/wp-content/uploads/2024/06/RELACION-MBI-MONITORIMIN-janar-Prill-2024.pdf>

78 <https://idp.al/plani-i-integritetit-2022-2025/>

79 <https://idp.al/2022/09/29/plani-i-integritetit-2022-2025-instrument-pergjegjshmerie-dhe-transparence-per-publikun/>

Kontrolli ligjor dhe institucional	Verifikimi	Vlerësimi	Shënime dhe analiza
	Institucioni ka monitoruar dhe ka hartuar një Raport Monitorimi të Planit të Integritetit	1 nga 1	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka monitoruar dhe ka hartuar një Raport Monitorimi të Planit të Integritetit për vitin 2023. KDIMDHP e ka publikuar në faqen e vet të internetit këtë Raport Monitorimi. <sup>80</sup>
<b>Zbatimi i sistemit të menaxhimit të integritetit</b>	Institucioni ka ngritur një strukturë të brendshme (grup pune/koordinator) për zbatimin e planit të integritetit.	2 nga 2	Institucioni ka caktuar një person përgjegjës në institucion për zbatimin e Planit të Integritetit. Me Urdhri Nr. 67, datë 5.5.2023 (Nr. Prot. 893), të KDIMDHP është caktuar koordinatori për monitorimin e Planit të Integritetit për Zyrën e Komisionerit 2022-2025. Qartësohet se koordinatori do të jetë përgjegjës për monitorimin e Planit të Integritetit dhe hartimin e një raporti vjetor për situatën e aktiviteteve dhe masave që duhet të merren gjatë realizimit të secilit aktivitet. Në cilësinë e koordinatorit është caktuar Zj. Pamela Begaj, Inspektore pranë Drejtorisë së Çështjeve Juridike dhe Integritetit. <sup>81</sup>
<b>Kontrolli ligjor dhe institucional</b>		<b>9 pikë nga 10</b>	

80 [https://idp.al/wp-content/uploads/2024/07/raporti\\_i\\_monitorimit\\_te\\_planit\\_te\\_integritetit.pdf](https://idp.al/wp-content/uploads/2024/07/raporti_i_monitorimit_te_planit_te_integritetit.pdf)

81 <https://idp.al/wp-content/uploads/2024/08/Urdhri-per-kordinatorin-e-Planit-te-Integritetit.pdf>

Kontrolli i zbatimit në praktikë	Verifikimi	Vlerësimi	Shënime dhe analiza
<b>Menaxhimi organizativ dhe menaxhimi i integritetit kryhet nëpërmjet një qasjeje strategjike</b>	Plani i integritetit për institucionin bazohet në analizën e risqeve ndaj integritetit dhe përmban masa për menaxhimin e tyre.	2 nga 2	<p>Plani i Integritetit i KDIMDHP-së përmban gjithsej 23 masa të hartuara, të lidhura me risqet e identifikuar nën objektivat e mëposhtëm:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore dhe forcimi i kapaciteteve njerëzore në lidhje me etikën dhe integritetin;</li> <li>2. Rritja e transparencës dhe mbrojtja e të dhënave personale;</li> <li>3. Përmirësimi i sistemit të ruajtjes së dokumentacionit dhe digjitalizimi i arkivit, masave me risqet e identifikuar, planin e zbatimit dhe treguesit e monitorimit.</li> </ol> <p>Plani i Integritetit është i publikuar në faqen e internetit të institucionit.<sup>82</sup></p>
	Numri i masave me rrezik të lartë kundrejt totalit të masave është >25%.	0 nga 2	Lidhur me fokusin e Planit të Integritetit, vlerësohet se 4 masa nga 23 gjithsej, pra 17%, (masa 7 dhe 8, Objektivi II dhe masa 1 dhe 2 Objektivi III) janë me risk të lartë, ndërsa 2 me risk të ulët dhe të gjithë të tjerët me risk mesatar. Referuar Indeksit të Integritetit, vetëm kur numri i masave me rrezik të lartë kundrejt totalit të masave është >25% Plani i Integritetit ka fokus risqet ndaj integritetit institucional. Ky tregues në rastin e Planit të Integritetit të KDIMDHP-së llogaritet vlerësohet me 0 pikë. <sup>83</sup>

82 [https://idp.al/wp-content/uploads/2024/01/2.-22\\_9\\_22-Plan-Integriteti-IDP-.pdf](https://idp.al/wp-content/uploads/2024/01/2.-22_9_22-Plan-Integriteti-IDP-.pdf)

83 Nga takimi me KDIMDHP-në na u prezantua se Plani i Integritetit që po zbatohet është i pari që ata kanë realizuar. Në vijim, institucioni do të rishikojë masat me qëllim forcimin e mëtejshëm të angazhimit për forcimin e integritetit, duke mbajtur në konsideratë edhe këtë element të Indeksit të Integritetit. Shih Planin aktual të Integritetit në: [https://idp.al/wp-content/uploads/2024/01/2.-22\\_9\\_22-Plan-Integriteti-IDP-.pdf](https://idp.al/wp-content/uploads/2024/01/2.-22_9_22-Plan-Integriteti-IDP-.pdf)



Kontrolli i zbatimit në praktikë	Verifikimi	Vlerësimi	Shënime dhe analiza
	<p>Institucioni monitoron zbatimin e planit të integritetit. Raporti i monitorimit tregon se 60% e masave të tij për atë periudhë zbatimi që është në monitorim janë zbatuar.</p>	<p>2 nga 2</p>	<p>KDIMDHP ka hartuar, monitoruar dhe raportuar monitorimin e Planit të Integritetit për vitin 2023. Raport monitorimi - zbatimi i Planit të integritetit të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale 2023 është botuar në faqen e internetit të institucionit.<sup>84</sup></p> <p>Nga 23 masa gjithsej, për vitin 2023 janë realizuar 18 gjithsej, pra 78% e masave gjithsej, dhe konkretisht: Objektivi I: Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore dhe forcimi i kapaciteteve njerëzore në lidhje me etikën dhe integritetin (10 masa të parashikuara për vitin 2023, nga të cilat 8 janë realizuar plotësisht). Objektivi II: Rritja e transparencës dhe mbrojtja e të dhënave personale (9 masa të parashikuara për vitin 2023, nga të cilat 6 janë realizuar gjatë 2023 plotësisht dhe Objektivi III: Përmirësimi i sistemit të ruajtjes së dokumentacionit dhe digjitalizimi i arkivit (4 masa të parashikuara për vitin 2023).<sup>85</sup></p>
	<p>Raporti i monitorimit përmban rekomandime (të paktën një rekomandim) për përditësimin e planit të integritetit.</p>	<p>2 nga 2</p>	<p>Raport monitorimi - zbatimi i Planit të integritetit të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale 2023 ka të përfshirë në faqen 10-11 pjesën "Konkluzione dhe Rekomandime". Konkluzionet janë pasqyrim i qartë i gjetjeve të monitorimit, ndërsa rekomandohet marrja e masave për ndjekjen dhe përmbushjen e objektivave në proces me qëllim shmangien e risqeve të evidentuara. Po ashtu, vlerësohet e nevojshme marrja e masave për nisjen e procesit të hartimit të Planit të ri të Integritetit të Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.<sup>86</sup></p>

84 [https://idp.al/wp-content/uploads/2024/10/09-10-2024-Raport-Monitorimi\\_KDIMDP.pdf](https://idp.al/wp-content/uploads/2024/10/09-10-2024-Raport-Monitorimi_KDIMDP.pdf)

85 Po aty.

86 Po aty, fq. 10-11.

Kontrolli i zbatimit në praktikë	Verifikimi	Vlerësimi	Shënime dhe analiza
	Institucioni ka emëruar një person përgjegjës për zbatimin e planit të integritetit - personi përgjegjës ushtron funksionin në bazë të vendimit të emërimit ku specifikohen përgjegjësitë dhe detyrat	2 nga 2	Institucioni ka miratuar një urdhër për caktimin e personit përgjegjës për zbatimin e planit të integritetit dhe në të është përcaktuar qartë detyra e tij, si përgjegjës për monitorimin e Planit të Integritetit dhe hartimin e një raporti vjetor për situatën e aktiviteteve dhe masave që duhet të merren gjatë realizimit të secilit aktivitet. <sup>87</sup>
Kontrolli i zbatimit në praktikë		8 pikë nga 10	
Totali i vlerësimit		17 pikë nga 20	

87 <https://idp.al/wp-content/uploads/2024/08/Urdhri-per-kordinatorin-e-Planit-te-Integritetit.pdf>

### 3.1 KUADRI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL

Bazuar në mekanizmat e qasjes strategjike KDIMDHP është një institucion që zhvillon veprimtarinë e tij në përputhje me strategjinë institucionale 2022-2025, të hartuar dhe publikuar në faqen e internetit. Kjo strategji përfshin objektivat dhe masat konkrete për përmirësimin e qeverisjes dhe transparencës (Indeksi i Integritetit, kriteri 'Planifikimi i operacioneve të institucionit'). Strategjia mbështetet nga një plan masash dhe shoqërohet me procedura standarde të veprimit për proceset kryesore të institucionit, të cilat ndihmojnë në monitorimin e aktiviteteve për përmbushjen e objektivave (shih kriterin më lart). Institucioni përmbush kriteret e përcaktuara nga metodologjia e indeksimit të integritetit të institucioneve publike, duke siguruar një transparencë të plotë në publikimin e Planit të Integritetit, i cili mbulon periudhën kohore 2022-2025.

Plani i Integritetit në përgjithësi dhe Plani i Veprimit në veçanti bazohen në katër objektiva të qarta, të cilat janë në funksion të integritetit dhe transparencës institucionale, zgjerimin e marrëdhënieve ndërkombëtare, rritjen e kapaciteteve institucionale, dhe rritjen e rolit në ndërgjegjësimin dhe promovimin e të drejtave të qytetarëve. Me qëllim përmbushjen e çdo objektivi, Plani i Veprimit identifikon risqe konkrete dhe masat që duhen marrë për zbatimin ose minimizimin e tyre. Në total, Plani i Veprimit ka identifikuar 23 risqe, nga të cilat 17 me ndikim "mesatar", 4 me ndikim "të lartë" dhe 2 me ndikim "të vogël". Për çdo risk të identifikuar, Plani i Veprimit parashikon masa kontrolli ose rekomandime konkrete për minimizimin e riskut.

Një tjetër hap pozitiv institucional janë Procedurat Standarde të Veprimit (PSV) për procese të ndryshme të punës së institucionit, të cilat janë pjesë përbërëse e dokumenteve të ndryshëm, kryesisht me karakter rregullator, për organizimin dhe funksionimin e KDIMDHP, por njëkohësisht rregullojnë dhe udhëzojnë proceset e punës së këtij institucioni (shih Indeksën 'Institucioni ka të publikuar Procedurat Standarde të Veprimit (PSV) ose gjurmët e auditimit për proceset e punës së institucionit').

### 3.2 KONTROLLI I ZBATIMIT NË PRAKTIKË

Nga kontrolli i zbatimit në praktikë të qasjes strategjike rezulton se, raporti i monitorimit të zbatimit të Planit Strategjik të Institucionit është publikuar në faqen e internetit të institucionit, ku raportohet se 87.1% e masave për vitin 2023 janë realizuar (shih më lart Indeksën "Institucioni ka të publikuar raportin e monitorimit të zbatimit të Planit Strategjik të Institucionit"). Shih grafikun 8.

KDIMDHP ka ngritur një strukturë të brendshme për zbatimin e Planit të Integritetit dhe ka caktuar Koordinatorin për monitorimin e tij, si dhe hartimin e një raporti vjetor për situatën e aktiviteteve. Në monitorimin e zbatimit të Planit të Integritetit për vitin 2023, rezulton se janë realizuar 18 nga 23 masat e vendosura. Ky raport përmban rekomandime që ndihmojnë në përmbushjen e objektivave dhe shmangien e risqeve të evidentuara. Gjithashtu, vlerësohet se duhet nisur procesi i hartimit të Planit të ri të Integritetit.

Grafiku 8. Masat e realizuara. Raporti periodik 1-vjeçar i monitorimit të strategjisë institucionale 2022-2025 për vitin 2023



Lidhur me menaxhimin organizativ dhe të integritetit, institucioni ka hartuar 23 masa që lidhen me risqet e identifikuar. Nga analiza e bërë rezulton se vetëm 17% e masave janë cilësuar si me rrezik të lartë, një kriter që nuk përmbush standardin e metodologjisë së indeksit të integritetit të institucioneve publike. Shih grafiku 9.

Grafiku 9. Kategorizimi i masave sipas Planit të Veprimit të Planit të Integritetit 2022 -2025



### 3.3 REKOMANDIME PËR QASJEN STRATEGJIKE

Në kuadër të përmirësimit të Qasjes strategjike, për KDIMDHP rekomandohet sa vijon:

- Vlerësim më gjithëpërfshirës: të realizohet një vlerësim më i thelluar për rritjen e masave me rrezikshmëri të lartë, me qëllim adresimin e çështjeve prioritare;
- Udhëzues për strategjinë e re: të hartohet një udhëzues paraprak që do të ndihmojë në hartimin e strategjisë institucionale dhe planit të ri të integritetit;
- Sigurimi i burimeve të mjaftueshme: të sigurohet rekrutimi i burimeve të mjaftueshme (njerëzore, financiare dhe administrative) për zbatimin efektiv të dokumenteve strategjike të institucionit.

## 4. INDEKSI I INTEGRITETIT - STANDARDET ETIKE DHE TË SJELLJES SË MIRË

Kontrolli ligjor dhe institucional	Verifikimi	Vlerësimi	Shënime dhe analiza
<b>Standartet etike/të integritetit</b>	Institucioni ka një Kod Etike/Sjelljeje apo një seksioni përkatës në një akt tjetër të brendshëm.	2 nga 2	<p>Kodi i Etikës i Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, miratuar si akt i posaçëm në vitin 2022 dhe publikuar në faqen e internetit të institucionit.<sup>88</sup> Ky kod informon të gjitha palët e interesuara lidhur me rregullat e sjelljes në Zyrën e Komisionerit, orienton nëpunësit për të përmbushur këto rregulla, si dhe ndihmon në identifikimin e rasteve, që janë të papajtueshme me këto rregulla.</p> <p>Kodi i Etikës përcakton rregullat për zbatimin e parimeve dhe standardeve të sjelljes etike nga nëpunësit e Zyrës së Komisionerit, gjatë ushtrimit të detyrave.</p>
	Institucioni ka zhvilluar seanca informative/ trajnime për kuadrin rregullator për etikën dhe integritetin me punonjësit e institucionit (administratë dhe staf politik)	1 nga 1	<p>Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka zhvilluar trajnime të ndryshme (përfshirë edhe vitin 2024) të cilat janë pasqyruar në faqen e internetit të institucionit, në <a href="https://idp.al/?swtrajnim">https://idp.al/?swtrajnim</a>.</p> <p>Me shkresën 117/1, datë 8.2.2021, është miratuar “Plani i trajnimeve për vitin 2021”, me shkresën 384/1, datë 28.2.2022, është miratuar “Plani i trajnimeve për vitin 2022”, me shkresën 265/1, datë 15.2.2023, është miratuar “Plani i trajnimeve për vitin 2023”, me shkresën 307/1, datë 9.2.2024, është miratuar “Plani i trajnimeve për vitin 2024”.</p> <p>Në vitet 2021-2023 janë zhvilluar në total 138 trajnime. Nga këto, 17 trajnime kanë qenë të dedikuara posaçërisht për etikën, ndërsa 12 të tjera kanë trajtuar aspekte të etikës. Planet e trajnimeve u vunë në dispozicion të printuara.</p>

88 <https://idp.al/wp-content/uploads/2024/01/Kodi-i-Etikes-2022.pdf>

Kontrolli ligjor dhe institucional	Verifikimi	Vlerësimi	Shënime dhe analiza
	Plani vjetor i trajnimeve te institucionit përmban trajnime për etikën dhe integritetin.	1 nga 1	Me shkresën 307/1, datë 9.2.2024 është miratuar “Plani i trajnimeve për vitin 2024” të KDIMDHP-së. Ky plan nuk përfshin trajnime të dedikuara posaçërisht për etikën, por plani përfshin trajnime (3 të tilla nga 9 gjithsej) që trajtojnë çështje të lidhura me etikën. Plani i trajnimeve për 2024 u nda elektronikisht dhe në kopje të printuar.
<b>Rregullat dhe procedurat për sjelljen jo-etike dhe mbrojtjen e sinjalizuesve</b>	Institucioni ka krijuar një njësi përgjegjëse dhe funksionale që regjistron, heton dhe shqyrton në mënyrë administrative raportet për veprimet ose praktikrat e dyshuara korruptive	1 nga 1	Bazuar në Nenin 10, ‘Sinjalizimi i brendshëm dhe njësitë përgjegjëse’ të Ligjit Nr. 60/2016, “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, i ndryshuar, <sup>89</sup> i cili parashikon ngritjen e një njësie përgjegjëse, e cila regjistron, heton administrativisht dhe shqyrton sinjalizimet vetëm kur autoriteti publik ka më shumë se 80 të punësuar, Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (që ka një personel më të vogël se 80 persona) nuk ka detyrimin ligjor të pasjes së një njësie të tillë.
	Institucioni ka hartuar një rregullore të brendshme të miratuar që përcakton procedurat për hetimin administrativ të rasteve të sinjalizimit dhe mekanizmat e mbrojtjes së konfidencialitetit	1 nga 1	Në faqen e internetit të KDIMDHP-së nuk gjendet një rregullore për sinjalizimin. Rregullorja e përgjithshme e institucionit nuk përfshin rregulla për sinjalizimin.  Gjithsesi, theksohet se KDIMDHP nuk ka detyrim ligjor, në respektim të parashikimeve në nenin 10 “Sinjalizimi i brendshëm dhe njësitë përgjegjëse” të Ligjit Nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, i ndryshuar.

89 <http://qbz.gov.al/eli/ligj/2016/06/02/60-2016>

Kontrolli ligjor dhe institucional	Verifikimi	Vlerësimi	Shënime dhe analiza
	Rregullat dhe procedurat për njoftimin, shqyrtimin, zbulimin dhe raportimin e mangësive, mospërputhjeve dhe shkeljeve jo-etike.	1 nga 1	KDIMDHP në rregulloren e brendshme ka të parashikuar struktura për trajtimin e situatave problematike. KDIMDHP ka krijuar edhe një njësi të posaçme për auditimin e shkeljeve të të dhënave personale. Janë mekanizmat e ngritjes së komisioneve disiplinore në rastet e shkeljeve ligjore. Na u vu në dispozicion Urdhri Nr. 0204, datë 30.12.2020, "Për ngritjen e komisionit disiplinor" në institucion, si dhe një shembull ecurie disiplinore për punonjësin E. M.
<b>Rregullat për konfliktin e interesit</b>	Institucioni ka ngritur autoritetin përgjegjës për parandalimin e konfliktit të interesit dhe ka miratuar rregulloren përkatëse.	2 nga 2	Me Urdhrin Nr. 134, datë 25.8.2014, Nr. Prot. 51/4, "Për caktimin e Autoritetit Përgjegjës" Nr. 134, datë KDIMDHP ka caktuar Znj. Lindita Morina, Drejtore e Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse, në cilësinë e autoritetit përgjegjës në institucion.  Po ashtu, KDIMDHP ka të miratuar dhe publikuar online "Rregullore për parandalimin e konfliktit të interesave" <sup>90</sup>
	Institucioni raporton rregullisht për ILDKPKI me regjistrin e konfliktit të interesit .	1 nga 1	Institucioni raporton periodikisht pranë ILDKPKI-së për ecurinë dhe problematikën e ndeshur gjatë vitit raportues. Pjesë e raportimit është dhe lista e plotë e zyrtarëve të cilët janë subjekt deklarimi, bazuar në regjistrin themeltar të zyrtarëve që mbartin detyrim për deklarim të interesave private. Raportet Nr. 212. Prot., datë 26.0 .2023 si dhe Nr. 269, Prot., datë 26.1.2024, mbi veprimtarinë e Autoritetit Përgjegjës të Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale u ndanë fizikisht dhe elektronikisht. <sup>91</sup>
<b>Kontrolli ligjor dhe institucional</b>		<b>10 pikë nga 10</b>	

90 <https://idp.al/rregullore-per-parandalimin-e-konfliktit-te-interesave/>

91 Kopje të këtyre raporteve u morën përgjatë takimeve të drejtpërdrejta me KDIMDHPnë.



Kontrolli i zbatimit në praktikë	Verifikimi	Vlerësimi	Shënime dhe analiza
	Numri i rasteve të raportuara apo trajtuara për konflikt interesi në një vit. (Referojuni njërit nga tre vitet e fundit nga periudha që po aplikoni vlerësimin).	2 nga 2	Institucioni nuk ka asnjë rast të konfliktit të interesit për vitet 2021, 2022, 2023 apo 2024. KDIMDHP ka raportuar pranë ILDKPKI-së se nuk ka raste të konfliktit të interesit në institucion në vitet 2021, 2022, 2023 apo 2024. <sup>92</sup> Në raportet paraqitur ILDKPKI-së, KDIMDHP raporton se "...të gjithë punonjësit, sipas strukturës së miratuar kanë plotësuar ose plotësojnë autorizimin për parandalimin e konfliktit të interesave, brenda afateve të përcaktuara në këtë legjislacion. Raste të reja për konflikt interesi, të pazgjidhura të raportuara në ILDKPKI, gjykatë apo prokurori nuk ka pasur". <sup>93</sup>
	Numri i rasteve të raportuara si raste të marrjes së ryshfetit, veprime korruptive dhe abuzim me detyrat (në një vit, referojuni një nga tre vitet e fundit nga koha që po aplikoni vlerësimin)	0 nga 2	KDIMDHP raportoi vetëm një rast ecurie disiplinore (rasti E. M.) në vitin 2020, për të cilin u vu në dispozicion kopja e vendimit. Gjithsesi, rasti nuk lidhet me ryshfet, veprime korruptive apo abuzimi. Burimet Njerëzore informuan se nuk kanë raste të ryshfetit, veprimeve korruptive apo abuzimi me detyrën të raportuara këto tre vitet e fundit në institucion.
	Numri i raste të regjistruara si dhurata apo mikpritje (në një vit, referojuni njërit nga tre vitet e fundit nga viti që po aplikoni vlerësimin).	0 nga 2	Institucioni nuk ka asnjë rast të regjistruar si dhuratë apo mikpritje në asnjë nga tre vitet e fundit si dhe nuk është raportuar për dhuratat.

92 Informacioni është marrë nga Shkresa Nr. 212. Prot. Tiranë, datë 26.0 .2023 "Dërgohet raporti për vitin 2022, mbi veprimtarinë e Autoritetit Përgjegjës të Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale", si dhe Shkresë Nr. 3 Prot. Tiranë, më datë 26.1.2024, "Dërgohet raporti për vitin 2023, mbi veprimtarinë e Autoritetit Përgjegjës të Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale." U administruan gjatë takimeve me KDIMDHP kopje elektronike të këtyre dokumenteve.

93 Shkresa Nr. 212, Prot. Tiranë, datë 26.0 .2023, fq. 3.

Kontrolli i zbatimit në praktikë	Verifikimi	Vlerësimi	Shënime dhe analiza
<b>Niveli i ekzistencës dhe zbatimit të standardeve të integritetit</b>	Akte të brendshme që dëshmojnë se ndërmerren veprime sipas Kodit të Etikës/të Sjelljes ose udhëzimeve për standardet e integritetit të institucionit.	2 nga 2	<p>Institucioni komunikon periodikisht për zbatimin e etikës në institucion përfshirë edhe merr masa për trajnime për aspekte të lidhura me etikën në institucion (shih më lart – trajnimet). Institucioni kryen komunikime të vijueshme përmes postës elektronike zyrtare, si p.sh. komunikimi me email datë 1.04.2023 për “Rregulloren për mbikëqyrjen e sjelljes së nëpunësit civil gjatë periudhës së fushatës elektorale për zgjedhjet vendore e detyrueshme për t’u zbatuar nga i gjithë stafi”, email nga sektori i Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Publikun, datë 6.04.2022, me objekt ‘Etika në Administratën Publike’ përmes të cilit komunikohet VKM Nr. 874, datë 29.09.2021, “Për miratimin e rregullave për zbatimin e parimeve të etikës”, email datë 2.2. 2024 për hyrje-daljen në institucion, email i datës 06.09.2023 për njoftimet në rastet e mungesave në punët, etj., të cilat adresojnë aspekte të ndryshme të etikës në punë. Komunikimet e përmendura u ndanë elektronikisht.</p> <p>Nuk ka raste të masave disiplinore për shkelje të etikës në institucion, edhe pse ka pasur raste të tërheqjes së vëmendjes së personave për orarin e punës dhe si shembull u soll rasti i një punonjësi në Drejtorinë e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për të cilin ka pasur komunikime të brendshme për të qartësuar situatën e respektimit të orarit në punë si një çështje e rregullave të etikës në institucion.</p>
	Vlerësim të rasteve të sinjalizuara të hetuara administrativisht nga njësia përgjegjëse (sipas nenit 13/1 të Ligjit 60/2016).	2 nga 2	Në mungesë të detyrimit ligjor për njësinë përgjegjëse për sinjalizimet (në respektim të parashikimeve në Nenin 10, “Sinjalizimi i brendshëm dhe njësitë përgjegjëse”, të Ligjit 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, i ndryshuar), KDMDHP nuk ka struktura që trajtojnë raste të sinjalizuara (sipas nenit 13/1 të Ligjit 60/2016). Ky kriter nuk zbatohet për institucionin.
<b>Kontrolli i zbatimit në praktikë</b>		<b>6 pikë nga 10</b>	
<b>Totali i vlerësimit</b>		<b>16 pikë nga 20</b>	

## 4.1 KUADRI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL

Bazuar në mekanizmat e llogaridhënies dhe kriteret e vlerësimit të indeksit të standardeve etike dhe të sjelljes së mirë të institucionit vlerësohet se KDIMDHP ka të përcaktuar qartë standardet etike dhe ka vendosur praktika të mirë-përcaktuara për zbatimin e tyre në institucion. Institucioni ka miratuar një kod etike të që rregullon sjelljen e punonjësve dhe që është publikuar në faqen e internetit të institucionit. Ky kod përcakton rregullat dhe standardet që nëpunësit duhet të respektojnë gjatë kryerjes së detyrave, duke përfshirë mënyrën e adresimit të rasteve të papajtueshme me këto rregulla (shih Indeksën 'Standardet etike/ të integritetit). Në përmbushje të konsolidimit të njohurive në lidhje me standardet etike, institucioni i KDIMDHP-së ka zhvilluar rregullisht trajnime për etikën dhe integritetin, të cilat janë të pasqyruar në faqen e internetit të institucionit.

## 4.2 KONTROLLI I ZBATIMIT NË PRAKTIKË

Nga kontrolli i zbatimit në praktikë të standardeve etike dhe të sjelljes së mirë rezulton se institucioni ka miratuar një plan vjetor të publikuar në faqen e internetit. Gjatë viteve 2021-2023, janë zhvilluar 138 ditë trajnime me qëllim përmirësimin e sjelljes etike në institucion dhe këto trajnime janë pjesë e programit të përgjithshëm të zhvillimit të kapaciteteve. Meqenëse KDIMDHP është një institucion me më pak se 80 punonjës, nuk ka detyrimin ligjor për ngritjen e një strukture për regjistrimin, hetimin dhe shqyrtimin e rasteve të veprimeve apo praktikave të dyshuara korruptive. Për këtë arsye, nuk ka një rregullore për sinjalizimin. Institucioni ka procedurë të qarta për trajtimin e rasteve disiplinore dhe shkeljeve etike. Për çdo shkelje, krijohen komisione disiplinore që hetojnë dhe japin vendime bazuar në standardet e përcaktuara në rregulloret e brendshme. Raportet disiplinore, si ai për punonjësën E. M., tregojnë se mekanizmat për monitorimin e etikës funksionojnë. Në rastet e shkeljeve të ndryshme jo-etike, institucioni ka parashikuar në rregulloren e tij struktura për krijimin e një njësie të posaçme për auditimin e shkeljeve disiplinore. Institucioni ka ngritur një autoritet përgjegjës për parandalimin e konfliktit të interesit dhe ka publikuar një rregullore për këtë qëllim. Rastet për të cilat është dhënë vërejtje në institucion lidhen kryesisht me respektimin e orarit të punës. Trajnimet ekzistuese kanë qenë efektive.

Institucioni ka miratuar Kodin e Etikës në vitin 2022. Për të siguruar që ai mbetet i përshtatshëm për situatat dhe sfidat e reja, duhen përfshirë praktika të reja për integritetin si për shembull në epokën digjitale.

## 4.3 REKOMANDIME PËR STANDARDET ETIKE DHE TË SJELLJES SË MIRË

Në kuadër të përmirësimit të standardeve etike dhe të sjelljes së mirë, rekomandohet që:

- Institucioni të ketë në vëmendje hartimin e një rregulloreje për sinjalizimin, në përputhje me rritjen e standardeve të integritetit;
- Të thellohet bashkëpunimi me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASP), aktorë të ndryshëm të shoqërisë civile dhe donatorët për ofrimin e trajnimeve periodike mbi etikën dhe integritetin për punonjësit e KDIMDHP-së dhe të përforcohen rregullisht njohuritë për praktikën etike, veçanërisht për çështje të reja që lidhen me integritetin, transparencën, automatizimin e shërbimeve dhe masat parandaluese kundër korrupsionit;
- Të merren masa që rregullat për dhuratat, premtimet dhe/ose favoret të mos mbeten formale, si dhe të miratohen rregulla për praktikën e mundshme të donacioneve apo sponsorizimeve;
- Të bëhet një vlerësim i rregullt i Kodit të Etikës, për të siguruar që ai mbetet i përshtatshëm për situatat dhe sfidat e reja, duke përfshirë praktika të reja për integritetin në epokën dixhitale.

## 5. INDEKSI I INTEGRITETIT – MERITOKRACIA

Kontrolli ligjor dhe institucional	Verifikimi	Vlerësimi	Shënime dhe analiza
Rekrutimi sipas meritës	Vendet e lira të punës në institucion shpallen publikisht. Meritokracia reflektohet në shpalljen e kërkesave për t'u përmbushur nga kandidatët	2 nga 2	<p>Organika e KDIMDHP-së është e përbërë nga 60 vende pune gjithsej,<sup>94</sup> ndërsa faktikisht numri i të punësuarve është më i ulët.</p> <p>Me Vendimin e Kuvendit Nr. 24/2024, "Për miratimin e disa ndryshimeve në Vendimin e Kuvendit Nr. 86/2018 'Për miratimin e strukturës, organikës dhe miratimit të pagave të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe të Dhënave Personale'", i ndryshuar, numri i përgjithshëm i punonjësve është shtuar për të arritur në 60 gjithsej.<sup>95</sup> Ky numër ka mbetur i pandryshuar edhe me Vendimin Nr. 8/2024 të Kuvendit "Për miratimin e disa ndryshimeve në Vendimin e Kuvendit Nr. 86/2018 'Për miratimin e strukturës, organikës dhe miratimit të pagave të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe të Dhënave Personale'", i ndryshuar, i cili solli disa ndryshime në strukturën e institucionit.<sup>96</sup></p> <p>Raporti Nr. Prot. 1429/1, datë 1.09.2023<sup>97</sup> si dhe raporti Nr. Prot. 1974/2, datë 30.08.2024<sup>98</sup> për zbatimin faktik të PBA-së pasqyrojnë problematikën në rekrutimin e burimeve njerëzore për shkak të mungesës së mbështetjes buxhetore, pavarësisht shtesave të vendeve sipas Vendimeve të Kuvendit për strukturën dhe organikën në institucion.</p>

94 <https://idp.al/organika/>

95 [https://idp.al/wp-content/uploads/2024/03/Vendimi-nr-24-2023-kuvendi.new\\_.pdf](https://idp.al/wp-content/uploads/2024/03/Vendimi-nr-24-2023-kuvendi.new_.pdf)

96 Shih Vendimin e Kuvendit në: [https://idp.al/wp-content/uploads/2024/02/vendimi\\_i\\_kuvendit\\_8\\_2024-1.pdf](https://idp.al/wp-content/uploads/2024/02/vendimi_i_kuvendit_8_2024-1.pdf)

97 [https://idp.al/wp-content/uploads/2024/08/Scan2024-08-07\\_150440.pdf](https://idp.al/wp-content/uploads/2024/08/Scan2024-08-07_150440.pdf)

98 <https://idp.al/wp-content/uploads/2024/09/FZ-Teknike-2025-2027.pdf>

Numri i të punësuarve në total gjatë vitit 2022 ishte 49<sup>99</sup> dhe gjatë 2023 ishte 52 veta<sup>100</sup>. Kjo konfirmohet edhe nga Raporti i monitorimit të KMSHC-së për institucionin.<sup>101</sup> Gjatë 2024 institucioni punësoi edhe një nëpunës civil.

Vendet e lira të punës shpallen publikisht nga KDIMDHP. Në faqen e vet të internetit, në menynë kryesore 'Autoriteti', nën titullin e qartë 'Vende vakante' shpallen vendet e lira të punës që shfaqen në institucion.<sup>102</sup>

KDIMDHP shpall publikisht planin vjetor të pranimit/rekrutimit në shërbimin civil.<sup>103</sup> Raporti i KMSHC-së për institucionin, 2024 ka tabelën e mëposhtme të përfshirë për konkurrimet e zhvilluara në institucion gjatë viteve 2021-2024. Shih tabelën 1.

**Tabela Nr. 1: Procedurat e konkurrimit për pozicionet e shërbimit civil**

<b>Procedurat e konkurrimit të zhvilluara për pozicionet e shërbimit civil</b>					
Viti kalendarik	Nr. i konkurremeve të shpallura	Nr. i pozicioneve për t'u plotësuar (sipas aktit të shpalljes)	Nr. i kandidatëve fitues nëpërmjet "Lëvizjes paralele"	Nr. i kandidatëve fitues nëpërmjet "Pranimit në shërbimin civil" ose "Ngritjes në detyrë"	Nr. i pozicioneve të mbetura të lira sipas planit
<b>2021</b>	9	9	0	8	6
<b>2022</b>	3	3	1	2	6
<b>2023</b>	10	11	1	10	4
<b>2024</b>	16				

99 Shih Raport i monitorimit mbi performancën e produkteve/shpenzimeve për periudhën janar- dhjetor 2023, në <https://idp.al/wp-content/uploads/2024/02/RELACION-MBI-MONITORIMIN-janar-dhjetor-2023.pdf>

100 Shih Raport i monitorimit mbi performancën e produkteve/shpenzimeve për periudhën janar- dhjetor 2022, në <https://idp.al/buxheti-i-zyres-se-komisionerit/>

101 KMSHC në raportin për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në institucionin Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, se për shkak se buxheti për vitin 2023 është miratuar për 52 pozicione pune, institucioni, deri në datën 31.12.2023, ka funksionuar më këtë numër pozicione në strukturën e tij (shkresa Nr. 12758/1, datë 25.7.2023, e Ministrisë së Financave). KMSHC, raport (projekt), prill 2024, fq. 8. Shih në <https://idp.al/wp-content/uploads/2024/07/Raport-KMSHC.pdf>

102 Shih në <https://idp.al/vende-vakante/>

103 <https://idp.al/wp-content/uploads/2024/02/PLANI-I-REKRUTIMIT-2024.pdf>

Kontrolli ligjor dhe institucional	Verifikimi	Vlerësimi	Shënime dhe analiza
			<p>Si rrjedhojë e ndryshimeve në strukturën dhe organikën e institucionit, gjatë vitit 2024 u planifikuan të shpallen për rekrutim 16 vende.<sup>104</sup></p> <p>Rezulton që të jetë shpallur publikisht vetëm 1 pozicion në shërbimin civil, gjatë 2024, i cili është plotësuar. Institucioni është pjesë e shërbimit civil dhe ndjek për këto pozicione kërkesat e Ligjit Nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar,<sup>105</sup> dhe akteve nënligjore përkatëse,<sup>106</sup> të cilat bazohen në meritokraci.</p> <p>Gjatë muajit korrik 2024, në faqen e internetit të institucionit u shpall, në përputhje me ligjin për nëpunësin civil, informacioni “Për lëvizje paralele në kategorinë ekzekutive” për 1 (një) “Specialist”, në Sektorin e Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë, në Drejtorinë e Çështjeve Juridike dhe Integritetit Kategoria e Pagës IV-1, në datën 25.7.2024, dhe në vijim u publikua njoftim mbi listën e verifikimit paraprak dhe njoftim mbi listën e verifikimit. Për shkak se nuk u paraqit asnjë kandidaturë për lëvizje paralele, për të njëjtin pozicion u shpall ftesa pranim nga jashtë shërbimit civil dhe në vijim dokumentet e kryerjes së kësaj procedure: a) Njoftim mbi listën e verifikimit paraprak; b) Njoftim mbi listën e verifikimit; c) Njoftim mbi intervistën, dhe ç) Njoftim mbi fituesin.<sup>107</sup></p>
	Ka mungesë të punësimit me transparencë, ekzistojnë raste të bëra publike në media.	2 nga 2	Nuk rezulton të ketë raportime në media për raste punësimi jo meritokratike në administratën e KDIMDHP-së.

104 <https://idp.al/wp-content/uploads/2024/02/PLANI-I-REKRUTIMIT-2024.pdf>

105 Shih tekstin e ligjit në: <http://qbz.gov.al/eli/ligj/2013/05/30/152-2013>

106 Të tilla janë: VKM Nr. 243, datë 18.03.2015, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, i ndryshuar; VKM Nr. 242, datë 18.03.2015, “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e nivelit të ulët dhe të mesme drejtuese”, i ndryshuar, VKM Nr. 118, datë 5.3.2014 “Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të anëtarëve të TND-së, i ndryshuar, dhe VKM Nr. 108, datë 26.2.2014 “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”, i ndryshuar.

107 Shih në <https://idp.al/vende-vakante/>.

Kontrolli ligjor dhe institucional	Verifikimi	Vlerësimi	Shënime dhe analiza
------------------------------------	------------	-----------	---------------------

Institucioni ka një praktikë të vlerësimit të performancës së punonjësve.

1 nga 2

KDIMDHP respekton në praktikën e vet kuadrin ligjor për nëpunësin civil për vlerësimin e performancës së punonjësve. VKM Nr. 109, datë 26.2.2014, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë” përcakton hapat dhe formularët e vlerësimit për nëpunësit civilë. U verifikuan praktika të zbatimit të këtij parashikimi ligjor në institucion, të cilat gjenden në dokumentacionin e mbledhur me rastin e hartimit të këtij raporti, si praktika datë 8.01.2024, 09/01/2024, 10.1.2024, 09/01/2024, 15.01.2024, tej.<sup>108</sup> Po ashtu, Raporti i KMSHC-së, 2024, përfshin tabelën e plotë të vlerësimit të nëpunësve civilë në institucion, si vijon.<sup>109</sup>

#### Tabelë Nr. 2 Të dhënat e vlerësimit për nëpunësit civilë

Periudha e vlerësimit	Korrik – Dhjetor 2023			
	Shumë mirë	Mirë	Kënaqshëm	Jo kënaqshëm
Niveli i vlerësimit përfundimtar				
Numri i nëpunësve të vlerësuar për çdo nivel	4	17	10	-
<b>Totali</b>			31	

Tek formularët e vlerësimit, për nëpunësit civilë të verifikuar rezulton se hapësira ‘Komentet e zyrtarit raportues/Shpjegime’ nuk është e plotësuar.

Për nëpunësit civilë udhëzimi për punonjësit është VKM Nr. 109, datë 26.2.2014 “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”. Gjithashtu, KDIMDHP ka miratuar edhe “Listën e proceseve të punës për vlerësimin e rezultateve në punë”.

Institucioni nuk ka udhëzues dhe formularë apo praktikë vlerësimi për punonjësit e tjerë në institucion, jo nëpunës civilë.

108 Kopjet e këtyre praktikave janë në dokumentacionin mbështetës të këtij Raporti.

109 Shih fq. 42 të Raportit, në: <https://idp.al/wp-content/uploads/2024/07/Raport-KMSHC.pdf>

Kontrolli ligjor dhe institucional	Verifikimi	Vlerësimi	Shënime dhe analiza
	Raporti vjetor i performancës së punonjësve është hartuar, nga i cili formulohen udhëzime për menaxhimin e burimeve njerëzore.	1 nga 2	Institucioni ka hartuar raportet e performancës së punonjësve për vitin 2021, vitin 2022, datë 22.1.2022, vitin 2024, datë 21/2028. <sup>110</sup> Në fund të secilit prej këtyre raporteve zyra e burimeve njerëzore vlerëson se janë përdorur të tre shkallët e vlerësimit, dhe e vlerëson këtë si pasqyrim i realitetit të performancës për çdo nëpunës civil, dhe në të njëjtën kohë që e nxit nëpunësin të rrisë nivelin e tij profesional për të përmirësuar njohuritë dhe arritur rezultatet e kënaqshme e të pritshme. Identifikohet se nuk ka pasur asnjë ankimum rreth këtij procesi. Ndërsa këto raporte janë mekanizma mjaft pozitivë që ndihmojnë menaxhimin më të mirë të burimeve njerëzore, ato e kanë vëmendjen ndaj vlerësimit të performancës të nëpunësve civilë dhe jo te të gjithë personelit të institucionit. Mungojnë raportet e performancës për të gjithë punonjësit në institucion.
Trajnimi dhe edukimi	Plani vjetor i trajnimeve të institucionit	1 nga 1	Institucioni ka një plan trajnimesh vjetor për punonjësit e institucioneve. Plani Vjetor i Trajnimeve për vitin 2024, Nr. Prot. 307/1, datë 9.2.2024, përmban 8 tema trajnimesh të identifikuar, Plani Vjetor i Trajnimeve për vitin 2023, Nr. Prot. 265/1, datë 15.2.2023, përmban 8 tema trajnimesh të identifikuar, Plani Vjetor i Trajnimeve për vitin 2022, Nr. Prot. 384/1, datë 28.2.2023, përmban 5 tema trajnimesh të identifikuar, dhe Plani Vjetor i Trajnimeve për vitin 2021, Nr. Prot. 1171/1, datë 8.2.2021, përmban 7 tema trajnimesh të identifikuar. Këto plane vjetore, së bashku me listën e të trajnuarve gjatë 2019-2022, u vunë në dispozicion fizikisht dhe u ndanë edhe të skanuar elektronikisht.
Kontrolli ligjor dhe institucional		8 nga 10	

110 Raportet u vunë në dispozicion në format të printuar dhe të skanuara elektronikisht.



Kontrolli i zbatimit në praktikë	Verifikimi	Vlerësimi	Shënime dhe analiza
<b>Rekrutimi sipas meritës</b>	Numri i punonjësve të larguar nga puna/ totalit të numrit të të punësuarve (në%).	2 nga 2	KDIMDHP informon se ka 53 pozicione pune, sipas strukturës, ndërsa janë 39 të punësuar faktikisht në shërbimin civil në institucion. <sup>111</sup> Për vitin 2024 janë larguar 4 persona, 1 për shkak të daljes në pension dhe 3 larguar në institucione të tjera me akte pezullimi. Referuar këtij treguesi, ky numër është 7% i numrit të përgjithshëm të të punësuarve në institucion.
	Drejtorët e drejtorive kryejnë funksionet e tyre ligjore ne procedurat e emërimit/ shkarkimit te stafit	2 nga 2	KDIMDHP është pjesë e shërbimit civil në vend dhe pjesa më e madhe e punonjësve të saj gëzojnë statusin e nëpunësit civil. Ndaj tyre zbatohet Ligji Nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar. <sup>112</sup> Nga institucioni konfirmohet që drejtorët e drejtorive ushtrojnë të drejtat e tyre të njohura nga legjislacioni për nëpunësin civil, lidhur me procesin e rekrutimit dhe lirit të shërbimit civil. <sup>113</sup>  Në rregulloren e brendshme të KDIMDHP-së ka një referencë të përgjithshme për rregullimin e marrëdhënies së punës, që referon edhe tek marrëdhëniet epror-vartës, edhe pse jo shumë e përpunuar lidhur me funksionet në kuadër të procedurave të rekrutimit/ shkarkimit. <sup>114</sup>

111 Numri i përgjithshëm i punonjësve konfirmohet edhe nga Raporti i 2024 i KMSHC-së, në <https://idp.al/wp-content/uploads/2024/07/Raport-KMSHC.pdf>

112 Shih tekstin e ligjit në: <http://qbz.gov.al/eli/ligj/2013/05/30/152-2013>

113 Kuadri ligjor përfshin:

- Ligji Nr. 152/2016 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar;
- VKM Nr. 243, datë 18.03.2015, “Për pranim, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, i ndryshuar;
- VKM Nr. 242, datë 18.03.2015, “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e nivelit të ulët dhe të mesme drejtuese”, i ndryshuar;
- VKM Nr. 118, datë 05.03.2014, “Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të anëtarëve të TND-së, i ndryshuar;
- VKM Nr. 108, datë 26.2.2014, “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”, të ndryshuar;
- VKM Nr. 115 datë 05.03.2014, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”.

114 Shih Neni 34, “Rregullimi i marrëdhënieve të punës”, në [https://www.idp.al/wp-content/uploads/2024/01/Rregullore-e-Brendshme\\_KDIMDP-2021-1.pdf](https://www.idp.al/wp-content/uploads/2024/01/Rregullore-e-Brendshme_KDIMDP-2021-1.pdf)

Kontrolli i zbatimit në praktikë	Verifikimi	Vlerësimi	Shënime dhe analiza
	A sigurojnë rregulloret e brendshme/ Kodi Etik aktivitetin politik të punonjësve ekzistues të sektorit publik (p.sh. anëtarësimi në parti, shprehja e pikëpamjeve politike)?	0 nga 2	<p>KDIMDHP është pjesë e shërbimit civil në vend dhe pjesa më e madhe e punonjësve të saj gëzojnë statusin e nëpunësit civil. Ndaj tyre zbatohet Ligji Nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar,<sup>115</sup> i cili parashikon në Nenin 37, “Të drejtat politike të nëpunësve civilë”. Ky nën rregullon marrjen pjesë në veprimtari politike jashtë orarit zyrtar, shprehjen publike të bindjeve apo preferencave politike, qenien anëtar i partive politike si dhe anëtarë i organeve drejtuese të tyre, sikurse kandidimin dhe zgjidhjen në zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë apo për organet e qeverisjes vendore, duke përcaktuar qartë kufizimet e ushtrimit të këtyre të drejtave.</p> <p>Kodi i Etikës i institucionit ka përfshirë rregulla të posaçme që lidhen me të drejtat politike të punonjësve në tërësi. Në disa nene të tij përfshin rregulla për kryerjen e detyrave në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe të pavarur nga pikëpamjet politike, apo edhe kufizime për titullarin që të mos japë deklaratë të karakterit politik.<sup>116</sup></p> <p>Për periudhën e fushatave elektorale, me qëllim disiplinimin e përfshirjes së punonjësve në veprimtari politike, KDIMDHP ka miratuar akte të posaçme nënligjore, si vijon:</p> <p>Urdhër Nr. 31, datë 21.02.2023, “Për ngritjen e grupit të punës për monitorimin e sjelljes së nëpunësit civil gjatë periudhës së fushatës elektorale”, Shkresa Nr. 370/3 prot., datë 21.02.2023.</p> <p>Rregullore e brendshme e grupit të monitorimit, në lidhje me mbikëqyrjen e sjelljes së nëpunësve civilë gjatë fushatës elektorale”, Shkresa Nr. 370/2 prot., datë 21.02.2023.</p> <p>Nuk ka asnjë vërejtje për stafin për aktivitet të papërshtatshëm politik.</p>

115 Shih tekstin e ligjit në: <http://qbz.gov.al/eli/ligj/2013/05/30/152-2013>

116 Shembuj të dispozitave të tilla janë:

Neni 4 parashikon rregulla për kryerjen e detyrave në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në mënyrë të pavarur nga pikëpamja politike;

Neni 7 parashikon se nuk ka nevojë të raportohen veprimtaritë që kanë të bëjnë me aktivitetet që rrjedhin nga bindjet politike;

Neni 9 kufizon titullarin e institucionit nga dhënia e deklaratave apo që të shfaqë publikisht mendime dhe opinione, që bien ndesh me politikat e përgjithshme publike.

Shih Kodin Etik të institucionit në: <https://idp.al/wp-content/uploads/2024/01/Kodi-i-Etikës-2022.pdf>

Kontrolli i zbatimit në praktikë	Verifikimi	Vlerësimi	Shënime dhe analiza
	A kanë drejtuesit hapësira për t'u dhënë punonjësve stimuj që të kryejnë punën me transparencë, përgjegjshmëri dhe gjithë përfshirje, p.sh. nëpërmjet çmimeve, stimujve financiarë etj.?	1 nga 2	KDIMDHP ka disa shembuj të shpërndarjes së stimujve financiarë. <sup>117</sup> Komisioneri e ka realizuar këtë duke përdorur Fondin e veçantë për institucionin. Gjithsesi, nuk zbatohet një sistem i përdorimit të çmimeve apo stimujve ndaj punonjësve me qëllim që ato të kryejnë punën në përputhje me ligjin. Institucioni nuk përdor stimuj moralë të njohur në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore për promovimin e punonjësve që tregojnë standard të lartë etik, përgjegjshmërie dhe integriteti.
<b>Trajnimi dhe edukimi</b>	Raste të ankesave/konflikteve në punë të adresuara në KMSHC.	2 nga 2	Nuk rezulton të ketë pasur ankesa pranë KMSHC-së për konflikte në punë gjatë viteve 2021-2023 nga punonjësit e KDIMDHP-së.
<b>Kontrolli i zbatimit në praktikë</b>		<b>7 pikë nga 10</b>	
<b>Totali i vlerësimit</b>		<b>15 pikë nga 20</b>	

117 Të tillë janë Urdhër Shpërblimi Nr. 255 108900111QP2305UO2, Nr. 256 108900111QP2305UO3, apo Nr. 262 108900111QP2305UO2, datë 29.12.2023, të miratuar nga Komisioneri. Fotokopjet e këtyre urdhrave u ndanë elektronikisht përmes emailit.


## 5.1 KUADRI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL

Një sistem meritokratik është kusht i domosdoshëm për të pasur një sektor publik tërësisht funksional. Një sistem i tillë zvogëlon rrezikun e korrupsionit dhe promovon një perspektivë afatgjatë punësimi gjë që përforcon përkushtimin e punonjësve ndaj punës. Një sistem i tillë kontribuon në rritjen e integritetit të institucionit. Kur burimet njerëzore përzgjidhen për shkaqe që lidhen me interesat personale, ekonomike, apo politike, mund të krijohet lehtësisht një mjedis dekurajues për ushtrimin e funksioneve.

Që të krijohet një sistem i tillë politikat e menaxhimit të burimeve njerëzore nevojitet të bazohen tek meritokracia. Prandaj, praktikat e rekrutimit, qëndrimit në detyrë dhe përfundimit të punës, nevojitet të bazohen në legjislacionin përkatës dhe rregullat e brendshme të institucionit.

KDIMDHP është pjesë e shërbimit civil në vend. Marrëdhëniet e punës së nëpunësve civilë në këtë institucion rregullohen nga legjislacioni për nëpunësin civil në fuqi në vend.<sup>118</sup> Aktualisht institucioni ka të miratuar një organigramë prej 60 pozicioneve pune, 53 prej të cilave janë pjesë e shërbimit civil, dhe 7 të tjera jo, nga të cilat 1 është funksion i zgjedhur, pra titullari i institucionit, 3 janë funksione këshillimore, pra Kabineti i titullarit të institucionit, dhe 3 janë punonjës administrative. Shih grafikun 9.

Grafiku 10. Numri i të punësuarve sipas pozicioneve, sipas strukturës së miratuar



Institucioni ka planifikuar në PBA-në 2025-2027 një shtesë prej 10 vetash për vitin 2025, ndërkohë që në tre vitet e fundit organika e institucionit nuk ka qenë asnjëherë e plotësuar. Aktualisht institucioni ka të punësuar gjithsej 52 referuar PBA-në 2025-2027,<sup>119</sup> ndërsa është shtuar me një gjatë 2024. Shih tabelën 3 më poshtë.

118 Konkretisht, ajo bazohet në Ligjin Nr. 152/2016, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, VKM Nr. 243, datë 18.03.2015, "Për pranim, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive", të ndryshuar, VKM Nr. 242, datë 18.03.2015, "Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e nivelit të ulët dhe të mesme drejtuese", të ndryshuar, VKM Nr. 118, datë 5.3.2014 "Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të anëtarëve të TND-së", të ndryshuar, si dhe VKM Nr. 108, datë 26.2.2014 "Për planin vjetor të pranimin në shërbimin civil", të ndryshuar.

119 KDIMDHP, Nr. 1972/2 Prot. datë 30.8.2024, "Mbi dorëzimin e kërkesave të Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027" (Faza Teknike), Fq. 21, në <https://idp.al/wp-content/uploads/2024/09/FZ-Teknike-2025-2027.pdf>

**Tabela 3. Numri i punonjësve sipas strukturave organike**

Pasqyra nr.4 Numri i punonjësve sipas strukturave organike

Kodi		Emertimi							
Njesia e Qeverisjes Qendrore		Komisioneri per te Drejtes Informimit dhe Mbrojtjene te Dhenave personale							
Emertimi ministrise/Institucionit	Kodi i institucionit	2022		2023		2024	2025	2026	2027
		Numri i punonjësve PLAN	Numri i punonjësve FAKT	Numri i punonjësve PLAN	Numri i punonjësve FAKT	Numri i punonjësve PLAN	Parashikimi	Parashikimi	Parashikimi
1	KDIMDP	1,089,001	44	43	52	52	60	70	72
2									
3									
4									
5									
6									
Total ministria/grupi									

Mungesa e burimeve njerëzore është një pengesë për realizimin e funksioneve të institucionit. Ndonëse KDIMDHP respekton me rigorozitet kuadrin ligjor për shërbimin civil për vlerësimin e performancës, nuk ka një praktikë për vlerësimin e performancës së punonjësve që nuk janë nëpunës civilë. Nuk ka në aktet e brendshme rregullatore të këtij aspekti, Po ashtu, shihet se për nëpunësit civilë procesi i vlerësimit nuk trajtohet në çdo aspekt të tij me rëndësinë e duhur. Disa rubrika nuk plotësohen duke sjellë rrezikun që ky proces të shndërrohet në thjesht formalitet.

Institucioni ka nevojë ta trajtojë këtë problematikë me qëllim që ai të mos shndërrohet në fenomen. Po ashtu, institucioni duhet të përfshijë në raportet e vlerësimit të performancës sa vlerësimet për nëpunësit civilë aq edhe për ata që nuk janë nëpunës civilë.

KDIMDHP ndjek rregullat e identifikimit dhe realizimit të trajnimeve në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor për nëpunësin civil. Duhet vënë në pah se mbetet e nevojshme që personeli jo nëpunës civil të trajtohet, sa i përket forcimit të kapaciteteve me një qasje sistematike në institucion.

## 5.2 KONTROLLI I ZBATIMIT NË PRAKTIKË

Bazuar në dokumentacionin e bërë publik dhe të vënë në dispozicion, ky institucion shihet se është korrekt me hartimin e raporteve të performancës së nëpunësve civilë në KDIMDHP, por jo të të gjithë punonjësve në institucion. Edhe pse nëpunësit civilë përbëjnë shumicën e punonjësve në KDIMDHP-së, është me rëndësi jo më të pakët edhe matja e performancës së tyre po ashtu. Për nëpunësit civilë përdoren udhëzime të qarta për punonjësit është VKM Nr. 109, datë 26.2.2014, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”. Megjithatë, KDIMDHP nuk ka udhëzues dhe formularë vlerësimi për punonjësit e tjerë në institucion. KDIMDHP realizon, në bashkëpunim me aktorë të ndryshëm dhe sidomos ASPA-s, trajnime të shumta për punonjësit e tij. Numri i trajnimeve nga vitit 1999 deri në 2023 është mjaft i lartë, gjithsej janë 138 ditë trajnimi për punonjës të realizuara gjatë kësaj periudhe.

Një tjetër aspekt që vihet re është se ndonëse KDIMDHP e respekton ligjin për nëpunësit civilë për vlerësimin e punës së nëpunësve, formularët e vlerësimit kanë të paplotësuar hapësirën ‘Komentet e zyrtarit raportues/Shpjegime’. Procesi i vlerësimit është me rëndësi jo vetëm për të matur punën që kanë kryer nëpunësit, por edhe për të dhënë rekomandime, pasqyruar qasje lidhur me ushtrimin e detyrës të cilat vlejné për përmirësimin e punës në vijim. Ky proces nuk duhet të shihet si formalitet, por të merren masa për të plotësuar realisht hapësirat e formularit me qëllim përmirësimin e ushtrimit të detyrës.

KDIMDHP rezulton se ka ndërmarrë veprime konkrete për të përdorur stimuj financiarë ndaj punonjësve të institucionit, por këto veprime kanë qenë ad hoc dhe vetëm me karakter financiar. Institucioni nuk ka masa që të japin stimujt financiarë në mënyrë të qëndrueshme, sikurse nuk përdoren stimuj moralë, të njohur në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore për nxitjen e kënaqësisë së burimeve njerëzore dhe motivimin në ushtrimin e detyrës.

## 5.3 REKOMANDIME PËR MERITOKRACINË:

Në kuadër të përmirësimit të meritokracisë, rekomandohet që institucioni:

- Të ketë qasje të njëjtë me atë për nëpunësit civilë për vlerësimin periodik të punës edhe të punonjësve të tjerë, jo nëpunës civilë në institucion;
- Të ketë qasje të njëjtë për trajnimet për etikën dhe integritetin sikurse trajnime të përgjithshme;
- Të marrë masa që të shtrijë qasjen e realizimit periodik të trajnimeve tek të gjithë punonjësit;
- Të marrë masa që tek formularët e vlerësimit hapësira 'Komentet e zyrtarit raportues/ Shpjegime' të plotësohet me qëllim që procesi të mos jetë thjesht formalitet;
- Të bëjë një vlerësim të nevojave të realizimit të trajnimeve për proceset e vlerësimit real për punonjësit në institucion;
- Të marrë masa për të hartuar një raport periodik të performancës së të gjithë personelit të KDMDHP-së, nga i cili të formulohen udhëzime për menaxhimin e burimeve njerëzore;
- Të krijojë mekanizma stimulues për promovimin e punonjësve që tregojnë një standard të lartë etik, përgjegjshmërie dhe integriteti;
- Të marrë masat për plotësimin e pozicioneve me personel faktik sipas organikës.

## 6. VLERËSIMI I PËRGJITHSHËM SIPAS INDEKSEVE

INDEKSI	KONTROLLI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL	KONTROLLI I ZBATIMIT NË PRAKTIKË
Pikëzimi	45 pikë nga 50	41 pikë nga 50
Analiza	<p>KDIMDHP vlerësohet institucion me një nivel të përparuar të zhvillimit të integritetit institucional me një pikëzim të përgjithshëm të kriterit ligjor dhe institucional prej 45 pikëve nga 50 pikë në total.</p> <p>Institucioni i ka miratuar, rregulloret e brendshme, aktet administrative, planet operative (rregullat dhe procedurat) dhe të gjithë formularët, mekanizmat monitorues, etj., në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi që rregullojnë aspektet e veçanta të integritetit institucional. Ato janë në një format të përcaktuar qartë dhe të gjitha njësitë e institucionit e kanë të qartë se si duhet të përdoren këto dokumente</p>	<p>KDIMDHP vlerësohet institucion me një nivel të përparuar të zhvillimit të integritetit institucional me një pikëzim të përgjithshëm të kriterit të kontrollit të zbatimit në praktikë prej 41 pikëve nga 50 pikë në total.</p> <p>Institucioni publik ka secilin nga aspektet e renditura të integritetit të organizuar në mënyrë të rregullt sipas standardeve të integritetit; proceset administrative brenda institucionit kryhen sipas parimeve të integritetit, në përputhje me rregullat dhe procedurat e përcaktuara të kuadrit ligjor në fuqi, si edhe sipas dokumenteve të politikave të institucionit. Funkcionet e planifikimit, zbatimit, raportimit, monitorimit dhe vlerësimit zbatohen në mënyrë të vazhdueshme dhe institucioni është pararojë për sa i përket integritetit me sjelljen e tij institucionale.</p>

